



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

00 Numër: 25/2024
Data: 21.02.2024



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>
Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

Për: Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës-Istog

Në bazë të nenit 43 neni 45 dhe neni 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe nenit 48.3 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, neni 5 i Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

T H Ë R R A S

Mbledhjen e 24-të të rregullt të Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës. Mbledhja do të mbahet më: **29.02.2024, e Enjte**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati III, duke filluar me punë në ora 10:00.

R E N D D I T E:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shpallja në diskutim Publik e Draft - Statutit për QKMF në Komunën e Istogut,
4. Shpallja në diskutim Publik e Draft - Strategjia Komunale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2024 - 2027) dhe Plan i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2024 - 2026),
5. Shfuqizimi i Vendimit 00.Nr.195/2023 i datës 30.11.2023 për këmbimin e pronës së paluajtshme private me pronën e paluajtshme të komunës së Istogut.
6. Shfuqizimi i Vendimit 00.Nr.209/2023 i datës 28.12.2023 për plotësim dhe ndryshimin e vendimit 00Nr.13/2020 për dhënien në shfrytëzim me negocim të pronës së paluajtshme të komunës me "Ulpiana Balaj" ShPK.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronë private në emer të z. Ismet Halimaj.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronë private në emer të Arsim Avdijaj.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronë private në emer të Herolinda Osmanaj,
10. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova

Vërejtje :

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në mbledhje, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 paragrafi 39.8 të LVL.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e njëzet e tretë e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **31.01.2024**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------------------|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 15. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 16. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 17. <u>Negjdet Ramaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 18. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 5. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 19. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 6. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 20. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 7. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 21. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 8. <u>Liridona Lajçi Avdiaj, LDK;</u> | 22. <u>Lavdiqe Bujupaj, VV;</u> |
| 9. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 23. <u>Arian Shatri VV;</u> |
| 10. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 24. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 11. <u>Njomza Demaj, LDK;</u> | 25. <u>Andi Xhuraj PDK;</u> |
| 12. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 26. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 13. <u>Arianit Selmanaj AAK;</u> | 27. <u>Melis Smakic;</u> |
| 14. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u> | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Nënkryetari i Komunës, z. Ali Nimanaj, Drejtoret e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të DEMOS-it, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV - Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1") (Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-te e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në <https://www.youtube.com/watch?v=EBGVGVPqIKg>
https://www.youtube.com/watch?v=U7dDtFbLF_c
<https://www.youtube.com/watch?v=sdhASGmBcd8>

: “shembulli 3”).

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit– përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.

Hap punimet për mbledhjen e njëzet e tretë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës në sallë, prezent janë 26 të anëtarë të Kuvendit.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R e n d d i t e

1. Arsjetimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2023,
4. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2023,
5. Shqyrtimi i Raportit të punës së KKSBB-së për vitin 2023,
6. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetor 2023,
7. Shqyrtimi i Raportit të Planit të Integritetit për vitin 2023,
8. Shqyrtimi i Raportit të zbatimit të Planit të Veprimit për Transparencë për vitin 2023,
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Organizimin e Punës në Institucionet Edukative-Arsimore të Arsimit Parauniversitar të Komunës së Istogut,
10. Rishqyrtimi i Vendimit të Hartës Zonale të Komunës së Istogut 2024-2032,
11. Raporti Vjetor i Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve-Istog,
12. Raporti i Planit Strategjik për Trashëgimin Kulturore dhe Natyrore për komunën e Istogut 2023-2027,
13. Raporti i punës së KRM Ambienti, Njësia Operative Istog (janar-dhjetor) 2023,
14. Realizimi i planit, Objektivat e menaxhimit të mbeturinave dhe Plani operacional 2023,
15. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së KRM Ambienti, Njësia Operative Istog, për ngritjen e çmimit të shërbimit të grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave,
16. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit- pyes ekzekutivin dhe këshilltarët e Kuvendit a kanë diçka të shtojnë rreth pikave të rendit të ditës ose ndonjë pikë të re? Fjalën e ka drejtori Naim Behlulaj.

Naim Behlulaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Kërkoj që të futet në rend dite ndoshta pak me vonesë Formimi i komisionit për ndarjen e bursave dhe ankesave.

Kryesuesi i Kuvendit- mirë, a ka edhe dikush diçka të shtoj? Konsideroj që jo. Atëherë e hedh në votim, kush është që të futet kjo pikë e propozuar në rendin e ditës së sotme?

Konstatohet që nga 26 anëtarë të Kuvendit të pranishëm në mënyrë unanime miratohet që pika e propozuar nga drejtori Naim Behlulaj të futet në rendin e ditës për mbledhjen e sotme.

E hedh në votim rendin e ditës së sotme me gjithë pikën e propozuar? Kush është për?

Konstatohet që nga 26 anëtarë të Kuvendit të pranishëm në mënyrë unanime miratohet rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- në bazë të listës së nënshkrimeve të pranishëm janë 26 anëtarë të Kuvendit dhe mungon Fjolla Ukaj (që ka marrë pjesë në mbledhje).

Kryesuesi i Kuvendit- para se të fillojmë me pikën e dytë të rendit të ditës ju kisha lutur për mirëkuptim, drejtori i drejtorisë së Arsimit që ka për ta prezantuar pikën e nëntë, ka rast vdekje në familje dhe i duhet të shkoj. Nëse ka mundësi që pikën e nëntë ta procedojmë në fillim.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka ndonjë vërejtje, sugjerim në lidhje me procesverbalin e mbledhjes së kaluar? Konstatohet që nuk ka. E hedh në votim, kush është që të miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar?

Fjolla Ukaj arrin në mbledhje.

Konstatohet që nga 27 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 27 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit- materialin e keni pasur, nëse keni ndonjë pyetje apo sugjerimin urdhëroni? Fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj -përsëritet të gjithë të pranishmit! Disa pikave shumë të rëndësishme ju keni ikur, në mbledhjen që e kemi mbajtur për Planin e Punës së Kuvendit për vitin 2024 keni thënë që ka qenë faji i ekzekutivit dhe është dashur të përmbledhni. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- mirë Florin e pranojmë sugjerimin tënd. A e dëshiron fjalën dikush tjetër? Pasi që jo kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 9.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori i drejtorisë së Arsimit Naim Behlulaj.

Naim Behlulaj- materiali ju ka ardhur me kohë. Draft-Rregullorja i ka kaluar të gjitha procedurat, nëse keni diçka urdhëroni.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë e kam dhënë një vërejtje edhe mbledhjen e kaluar që të jetë një nen i veçantë që të gjithëpunonjësit në institucionet edukativo-arsimore janë të obliguar që të mbajnë uniformën gjatë qëndrimit në shkollë, sa i përket modelit dhe ngjyrës merr vendim këshilli i shkollës.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka edhe dikush që dëshiron të diskutoj? Fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Ne i kemi bërë disa kërkesa këtu, në mesin e tyre është zëvendësimi i orëve drejtori e din. Nga kush do të zëvendësohen ato orë në mënyrë që të realizohet plan programi. E kemi debatuar edhe orarin e kujdestarisë, kujdestari i klasës paraprakisht ta bëj programin për realizimin e kësaj ore mësimore, ka qenë një orë e kujdestarisë në javë, dhe mendoj që është jashtëzakonisht e domosdoshme marrë parasysh problemet e fëmijëve. Kutia e ankesave ka qenë edhe mandatin e kaluar, duhet të menaxhohet dhe të hapet ajo. Sa i përket uniformave ajo rregullore i mbulon të gjithë edhe mësimdhënësit edhe punëtorët ndihmës edhe stafin tjetër por varet sa menaxhohet bartja e uniformave është diçka tjetër. Si propozim e pata që ora e kujdestarisë ta ketë vendin në fondin javor si orë e veçantë me planprogram e me të gjitha si orët tjera.

Kryesuesi i Kuvendit- a parashihet në ligj? Nëse jo na kthejnë rregulloren.

Ajshe Metaj- atëherë kërkesat që ju i jepni përmes Rregullores bien poshtë, nuk kanë si të realizohen, në orën e kujdestarisë të shtunën nuk vjen askush, a bie ndesh a jo drejtori e ka fjalën na tregon neve.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori i Arsimit, Naim Behlulaj.

Naim Behlulaj- neni i veçantë që po e kërkojmë ndoshta është edhe i arsyeshëm por duke u bazuar në Rregulloren 2018 thotë që gjithë stafi menaxhues i shkollës duhet të jetë i pajisur me uniforma. Sa i përket zëvendësimit të orëve, udhëzimi administrativ thotë që duhet të zëvendësohen, sa i përket kujdestarisë është duke u përgatitur udhëzimi nga ministria të futet edhe ora e kujdestarisë si normë, por deri tani është e ndaluar me ligj.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! Fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- deri sa po kërkohen të kryhen obligime nga kujdestarët e klasës e nuk e ka hapësirën, kjo më ka shtyer që me e kërkuar kohën kur ka me vepruar kujdestari, këta duhet të insistojnë prej baze sepse nuk është punë e vetëm një norme por çështje si me ndikuar në zhvillimin e fëmijëve. Unë e kam arsyen time tani a bie ndesh a jo me ligjin është dikush tjetër që i vëren. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- nëpërmjet rregullores nuk mundesh se na kthejnë. Fjalën e ka Haki Podrimaj.

Haki Podrimaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Kam biseduar me disa që punojnë në arsim, të vetmen vërejtje që e kanë dhënë për shkak të kushteve është që ora të zgjatet 45 minuta, për shkak se ndërrimi i masdites për shkak të transportit ora e gjashtë është shumë vonë. Mirëpo, kam biseduar me drejtorin dhe ka thënë që është e rregulluar me udhëzim administrativ, prapë

drejtori e ka lënë nenin 10 pika 6 që bashkë me drejtorinë ta bëjnë këtë zgjidhje dhe në bazë të kushteve e caktojnë orën e mësimi, ata e kanë propozuar që kur është shkolla me një ndërrim të jetë ora 45 minuta e me dy ndërrime 40 minuta. E inkurajoj drejtorin që ta zbatojë këtë rregullore që është mjaft e mirë. Diçka konkrete nuk kam. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Andi Xhuraj.

Andi Xhuraj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë e kam një propozim, tek neni 30 pika 3 ku thotë që të punojë me dy grupe të fëmijëve brenda një institucioni nëse ka mbi njëzet fëmijë, në të kundërtën është i obliguar që me grupin tjetër të mbajë mësimin në një institucion shkollor tjetër, në të kundërtën nëse punon me një grup të fëmijëve atëherë paguhet me gjysmë norme. Unë propozoj që kjo pikë të hiqet për arsye se është shumë ngarkesë për edukatorët që gjysmën e orëve me e mbajtur p.sh në Vrellë gjysmën tjetër me ardhur në Istog, le të bëhet një analizë ose aty ku ka nevojë me u plotësuar me edukatorë të hapen konkurset të plotësohen me edukatorë të rinjë. Propozoj që kjo pikë të hiqet ose të ndryshohet. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori.

Naim Behlulaj- pyetje me vend por kjo është e përcaktuar me ligj.

Kryesuesi i Kuvendit- Andi e tha që një edukatore mos të shkojë në dy vende larg shkaku i udhëtimit.

Naim Behlulaj- po kryesuesi, po p.sh një edukatore nuk mundet ta lë Vrellën dhe të vijë në Istog, kemi numër të madh të mësimdhënësve dhe stafi arsimor po reduktohet e kemi edhe prej ministrisë. Me ligj është e obliguar, por ende nuk e kemi zbatuar sepse ka edukatore mjaft. Si rregullore nuk mundemi me e heq.

Kryesuesi i Kuvendit- Florin Dreshaj e ka fjalën.

Florin Dreshaj- faleminderit kryesues! Përshëndet të gjithë të pranishmit! I shpreh ngushëllime drejtorit në emër të Lëvizjes Vetëvendosje! Ne i kemi vërejtur disa mangësi, apo gabime teknike që kishin mundur të rregullohen. P.sh ku janë caktuar pikat ose nenet, sepse ka raste kur përsëriten, nuk e di a do të përmirësohet apo do mbetet kështu kjo rregullore si e votojmë ne? Atëherë ndoshta është më mirë ta lëmë këtë rregullore për muajin tjetër, nëse nuk është dipka për ngut, me i rregulluar këto gjëra, p.sh. te neni 20 'zëvendës drejtori i pranon plan programet e mësimdhënësve' te neni 34 'koordinatori i vlerëson programet' ndërsa te neni 32 'pedagogu u jep këshilla për këto plan programe mësimdhënësve'. Nuk kanë nevojë me u shëtit plan programet. P.sh koordinatori kur i vlerëson plan programet me i shikuar çka ka të meta, duhet me i treguar pedagogut pastaj pedagogu mësimdhënësit. Te neni 44, pika 1.7 dhe 1.8 janë njejtë. Në pamundësi për me diskutuar me kolegët mësimdhënës propozoj që të shtyhet kjo pikë për mbledhjen tjetër. Rregullorja nuk është e keqe por ka shumë gabime, ja fillon 1.1, 1.2, 1.3, përfundon me 1 dhe nuk fillon me 2 kurrë. Në qoftë se nuk ndryshohet atëherë Lëvizja Vetëvendosje voton kundër, ose propozoj që të shtyhet për muajin tjetër të vijë me përmirësime.

Kryesuesi i Kuvendit- nuk jam i atij domeni Florin, por besoj më mirë është që plan programi të shkojë te tre persona e të shihet se kush çfarë po bën për transparencë, në këtë aspekt po e them.

Florin Dreshaj- zëvendës drejtori nuk ka as me e shikuar vetëm ka me e marrë edhe me ja dërguar koordinatorit, pastaj koordinatori e vlerëson edhe ja jep pedagogut e ky pastaj ja bartë të dhënat mësimdhënësit. Pse po komplikohet kaq shumë? 84 nene që i ka kjo Rregullore mendoj që është tepruar.

Kryesuesi i Kuvendit- mirë. Kush është që të votohet, propozimi i Hajrush Shoshit?

Konstatojmë që nga 23 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 14 vota për 5 kundër dhe 4 abstenim miratohet propozimi i Hajrush Shoshit.

E hedhim në votim Rregulloren në tërësi, kush është për?

Konstatojmë që nga 23 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota për 0 kundër dhe 3 abstenim miratohet Rregullorja për Organizimin e Punës në Institucionet Edukative-Arsimore të Arsimit Parauniversitar të Komunës së Istogut.

Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Nënkyetari i komunës.

Nënkyetari i komunës- raportin e punës së kryetarit besoj që e keni marrë me kohë. Nëse doni me e lexuar në tersi e lexojmë. Nëse ka dikush pyetje urdhëroni.

Kryesuesi i Kuvendit- nënkyetar, po konsideroj që për shkak të pikave të shumta që i kemi në rend dite sot, materialin këshilltarët e kanë marrë me kohë, kështu që veç mundem me e hap diskutimin rreth kësaj pike. A ka dikush diçka rreth kësaj pike? Po konsideroj që jo. Faleminderit!

Shqyrtimi i pikës se 5.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Nënkyetari i komunës.

Nënkyetari i komunës- e ftoj Skender Hasangjekaj që ta prezantoj në pika të shkurta planin, materialin e keni pasur me kohë pastaj diskutojmë.

Skender Hasangjekaj- Shqyrtimi i Raportit të punës së KKSB-së për vitin 2023.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- përshëndet të gjithë të pranishmit! E kemi lexuar këtë raport edhe si raportet tjera i kam disa vërejtje për shkak të mos respektimit të këtyre raporteve, bëhen sugjerimet edhe gjetjet shumë të mira por nuk respektohen. I kam disa pyetje për koordinatorin e këtij komisioni. Pse nuk i përgjigjen drejtorët këtyre sugjerimeve që gjinden në të? E kemi parë edhe më parë që janë ankesat e njëjta, pra nuk rregullohen nuk zbatohen. I kam disa pika që i kam cekur këtu. Pika e parë është mos koordinimi me drejtorinë e Inspektionit ku ka ankesa më së shumti. Raporti ka gjetur shumë mangësi, sidomos te çështja e punësimit, mosrespektimin e orarit të punës, pastaj ka pasur gjetje të pushimeve, sidomos të pushimeve të lehonisë. Pastaj është pjesa e sigurisë dhe gjendjes afër shkollave apo nëpër sheshe ku ka pasur ankesa të

shumta. Ishte dashur që inspektorati me i parë pak këto gjëra. Kemi dhënë vërejtje edhe në raportin e kaluar edhe prapë janë bërë gjetjet e njëjta dhe nuk është ndërmarrë asgjë. Kisha pasur dëshirë që për këto me e bërë një koordinim ky komision, sepse po na vijnë raportet e njëjta, gjetjet janë shumë të mira, punimi i raportit është shumë i mirë por ka zero aktivitet nga drejtoria përkatëse. Pastaj te pjesa e arsimit e kemi parë që ka pasur mungesë të takimeve të këtij komisioni me shkollat që me pasur mundësi me i nxjerrë konkludimet për dhunën në shkolla, nuk e di pse nuk janë mbajtur këto takime me drejtorinë e arsimit. Ka pasur ankesa të mëdha edhe për vendparkingjet. Pastaj një çështje tjetër është trajtimi i ujrave, ku po ndoten lumenjtë, kam pasur edhe më herët pyetje dhe kërkesa lidhur me këtë, duhet të ndërmerret diçka nga drejtoria përkatëse. Duhet me u marrë pak me vërejtjet e qytetarëve sepse është gjendje shumë e keqe sa i përket sistemit të ujitjes. Pastaj pengesat në rrugë, sidomos te pjesa e shkollave, stacionit dhe te pjesa e qendrës ku ka kërkesa dhe ka nevojë për pengesa në rrugë. Faleminderit shumë!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- Agroni i përfshiu shumë mirë ato që desha ti them, zyrtari na sqaroi pse ky raport është kaq i varfër, por mua po më duket shumë e pa ndershme që ata anëtarë që duhet të marrin pjesë në mbledhje nuk vijnë në mbledhje edhe me i shqyrtuar gjërat, e jo për shkak të pagesës me mbetur raporti i varfër. Të gjeturat janë të njëjta po përsëriten, po nuk bëhet zgjidhje për to. Një pyetje e kam te vjedhjet që janë bërë, që janë 34 vjedhje të rëndomta, 37 të rënda, a kemi ndonjë raport sa prej këtyre vjedhjeve janë zbardhur? Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- shumicën e gjërave i theksuan kolegët, por me theks të veçantë kisha dashur te punëtorët e sektorit privat, sepse janë të diskriminuar në pikpamje të pagës në zgjatje të orarit, dhe kontratat e tyre nuk respektohen sa duhet, sepse punëdhënësit e sektorit privat kur duan i largojnë nga puna, sa janë këta të sigurve, duhet të drejtohen në mënyrë që të jenë të mbrojtur. U përmend edhe e diela të jetë ditë pushimi, ne e kemi përshëndet këtë, sepse e kemi kërkuar edhe mandatin e kaluar. Është thënë që komuna e Pejës e ka bërë, mund ta votojmë edhe ne këtu është e drejtë, mirëpo çështja qëndron në zbatueshmëri, sa jemi në gjendje t'i monitorojmë, duhet të rregullohen në bazë të një orari. Kam kërkuar që e diela të jetë ditë pushimi po kërkoj prapë nëse ka mundësi të votohet por a do të respektohet nga të gjithë kjo mbetet për tu parë. Tjetër isha ndalur tek arsimi, te bullizmi në shkollë dhe manipulimi me substanca narkotike që është një problem i madh, i kemi mjetet por si të zvogëlohet bullizmi, sepse është problem i madh në të gjitha shkollat, sepse nëse rëndohesh në një masë ai person që bullizohet mundet të mos ekzistoj më. Duhet të mobilizohen të gjithë faktorët. Ai që është pandërprerë është bullizmi në rrjete sociale, si mund të ndikojmë ne që fëmijët që janë në shkolla që ndihen të bullizuar të mos rëndohen më tutje. Është problem kudo në Kosovë. Pasi po flasim për bullizmin është thënë që në komunën tonë ka rënie, a keni marrë ndonjëherë ndonjë statistikë nëpër shkolla sa është numri i nxënësve që bullizohen? Dhe krahasuar me vlerat që kanë qenë dhe që janë tani a ka rënie apo rritje të bullizimit? Një tjetër parametër që është përmendur shumë është çështja e dhunës në familje, edhe këtu kërkoj njësoj një statistikë, në komunën tonë sipas të dhënave që i keni nga policia a është dhuna në familje në rënie apo në rritje? A kemi strehimore në komunën tonë, apo duhet të investojmë në strehimoren që e dimë që e kemi në Pejë, si dhe sa ndikojnë psikologët, pedagogët tek fëmijët e një familje që është ushtruar dhuna? Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Andi Xhuraj.

Andi Xhuraj- vërejtje ose diçka nuk kam, vetëm e kam një propozim që kolegët cili do që e merr fjalën, le të vjen me ndonjë kritikë ose propozim direkt p.sh te rastet e dhunës në familje e ke të cekur që janë 37 raste, po vanohemi me pyetje që i kemi në material.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- ne nuk jemi faktorë, sepse nuk na konvenon as neve të na humb minutazhi. Por është e rëndësishme të diskutohen këto gjëra. Faleminderit!

Skender Hasangjekaj- përgjigjet në pyetjet dhe sqaron më në detaje.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka nënkryetari i komunës.

Nënkryetari i komunës- ashtu siç u potencua nga koordinatori që KKSBJ-ja është trup këshilldhënës e kryetarit ku kryetari bën pjesë vet në këtë këshill. Shumicën e përgjigjeve i tha Skenderi, unë vetëm desha të çështja e Inspektoratit të punës, dhe punëtorëve në sektorin privat. Tek ky fenomen, që është diskutuar në KKSBJ dhe rekomandimet që janë dhënë kanë qenë shqetësim edhe për kryetarin edhe për këshillin sepse shumica çka u diskutuan qëndrojnë, për këtë arsye e kemi ftuar në këshill të raportojë edhe zyrën rajonale të inspektoriatit të punës, dhe sipas tyre e keni parë edhe në raport kanë dhënë sugjerime, gjoba, te sektori privat ku shkelen të drejtat e punëtorëve. Sa i përket pjesës të Inspektoriatit komunal te ndotja e lumenjëve e keni parë në raportin e punës së kryetarit që inspektorati ka dalë në terren ka bërë raporte dhe kanë dhënë gjoba.

Skender Hasangjekaj vazhdon me sqarimet dhe përgjigjet në pyetje.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- ne po e mundojmë koordinatorin por a ka drejtor që raporton?

Kryesuesi i Kuvendit- ky raporton për punën e vet për KKSBJ, ky është organ i veçantë i Kuvendit. A ka edhe dikush të diskutoj diçka? Pasi që jo, ju falënderoj!

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit- fjala është për ju Nënkryetar!

Nënkryetari i komunës- ja kalon fjalën drejtorit Genc Ademaj.

Genc Ademaj- përshëndet të pranishmit dhe prezanton pikën e rendit të ditës 'Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetor 2023.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! Fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Sa i përket këtij raporti e kemi parë që ka pasur suficit afër gjysmë milioni tek investimet kapitale, e me ato 1.3 milion të vitit të kaluar, po i bie që pothuajse 1.8 milion ose gati gjysma e buxhetit për një vit kalendarik për këtë kategori

që është e ndarë. Pyetja është pse kemi arritur te kjo shifër kaq e madhe? Sepse te kategoritë tjera nuk e keni lënë ndonjë përqindje pa e shpenzuar madje keni thënë që edhe është tejkaluar. Tek projekti i lumit Istog, me vite është duke u sjellë nëpër procedurat e prokurimit, e komuna po humb çdo vit që nuk po realizohet ky projekt. Pyetja është a e keni në plan të bëni ndonjë projekt të madh sepse përveç marrjes së meritave të punëve të qeverisë apo shpërdorimit të buxhetit me copëza të asfaltit dhe veturës luksoze diçka tjetër madhore nuk është që kemi parë e shkoi pothuajse gjysma e mandatit. Faleminderit!

Genc Ademaj- përgjigjet në pyetje dhe sqaron.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- unë drejtor i pata disa vërejtje, për disa terme, ka të hyra të tjera, taksa të tjera, dhe nuk sqarohen, nëse e marim një raport dhe duam ta analizojmë duhet ta dimë nga kanë ardhur, po ashtu ka p.sh te gjimnazi “Haxhi Zeka” e di që ka të hyra shumë më shumë janë paraqitur këtu vetëm 9.00 euro të hyra e kjo po më bën që mos ti besoj këtij raporti. Faleminderit!

Drejtori Genc Ademaj sqaron dhe përgjigjet në pyetje.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor. Florin Dreshaj replikë.

Florin Dreshaj- desha ta falënderoj drejtorin për informacionin që shkollat kanë me i pasur të hyrat e veta, për arsye se me vite të tëra, gjimnazi “Haxhi Zeka” është privuar nga shfrytëzimi i të hyrave të veta gjithmonë ja ka marrë shkolla teknike. Faleminderit edhe njëherë për informacionin!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- unë vetëm desha një sqarim që ta dijë opinioni, në suficit kanë shkuar vetëm 343 mijë e 221 euro d.m.th llogaritet suficit që është pjesë e grantit qeveritar, ndërsa pjesa tjetër mbetet prapë në komunë të cilën mundemi ta shfrytëzojmë, atë pjesë nuk e llogariti shumë suficit. Edhe desha një përgjigje Florinit që tha i ka shfrytëzuar shkolla teknike, unë sa kam informacione dhe sa kam qenë drejtor, çdoherë gjimnazi “Haxhi Zeka” i ka pasur të hollat e veta edhe shkolla teknike i ka pasur të vetat, nuk ka pasur përzierje asnjëherë të mjeteve financiare.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- kolegu Hajrush ka qenë edhe drejtor në atë kohë edhe e din nuk e di pse po mundohet t’i fshehë. Kam qenë në këshill drejtues të shkollës ku menaxhon me shpenzimet e shkollës, edhe çdo vit kanë kaluar mjete prej gjimnazit në shkollë teknike edhe kjo qëndron.

Genc Ademaj- jep sqarim.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- për hartimin e orarit mësimor drejtori ka thënë që nuk kam kod ekonomik për me ja u paguar prej buxhetit të shkollës, dhe ne jemi detyruar me i paguar nga 10.00 euro. A ka

tani mundësi që drejtori kur don ta paguaj me e pasur kodin ekonomik me ja qit paret atij personi që e harton orarin mësimor.

Genc Ademaj- te pjesa e punëve shtesë është e rregulluar me ligj. Është formulari standard që mundet me u kërkuar edhe te drejtoria e Arsimit edhe te drejtoria e Buxhetit, shkarkohet edhe normal pasurohet me një raport që dëshmon që zyrtari ka punuar një kohë të caktuar punë shtesë që nuk i ka në kontratë, edhe drejtori i aprovon edhe e bën kërkesën në DKA edhe zyrtarja e pagave e proceson.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- sot e kemi aprovuar një Rregullore, e cila e përcakton kush do ta bëj hartimin e orarit, është personi përgjegjës që merret me hartimin e orarit mësimor, ka detyra dhe përgjegjësi.

Kryesuesi i Kuvendit- Ajshe Metaj replikë.

Ajshe Metaj- rregulloren nuk e kam lexuar një herë por tri herë. Por personi që e harton një orar, nuk ka llogari që çdo vit ta bëjë sepse është punë delikate, ai duhet të kompensohet disi. Tani e mora vesh mënyrën nga mundet të kompensohet.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- desha një sqarim prej drejtorit sepse na ka premtuar në seancën e kaluar për familjet e veteranëve me e pasur një përgjigje për lirim nga taksat komunale.

Genc Ademaj- momentin që e kemi përfunduar mbledhjen, fatmirësisht Rregullorja është kthyer pozitiv dhe ka hyrë në fuqi. Kuvendi e ka bërë kërkesën pas mbledhjes dhe kryesuesi e ka përgjigjen nga MAPL-ja.

Kryesuesi i Kuvendit- po e shfrytëzoj rastin këtu. MAPL-ja e ka dërguar në Ministrinë e Financave, kështu që jemi në afate ligjore, atë ditë që e dërgojnë, prej asaj dite i kanë edhe pesëmbëdhjetë ditë, e ka marrë ministria e Financave në shqyrtim, decidiv nuk kam përgjigje, po presim përgjigje prej tyre. Faleminderit!
A dëshiron edhe dikush ta marrë fjalën? Po konsideroj që jo.

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka nënkryetari i komunës.

Nënkryetari i komunës- është Plan që ndikon në performancën e komunës, nëse ka pyetje konkrete, jemi të gatshëm.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit nënkryetar. E hapim debatin rreth kësaj pike? Agron Gashi e ka fjalën.

Agron Gashi- e kam shikuar këtë Plan të Integritetit, ka pasur shumë pika që ka pasur fokus të madh, që janë përmbushur ka pasur edhe çështje të caktuara që nuk janë përmbushur dhe janë renditur shumë keq, duke filluar nga drejtoria e Zhvillimit Ekonomik që kanë qenë disa gjetje

që kanë dalur kundër premtimeve, si pikë e parë start-up të bizneseve që hapen nga të rinjtë, është gjetur që nuk ka përkrahje të tyre, është përmendur edhe më herët premtimet klimë të favorshme për investitorët e huaj, krijimi i qendrave të biznesit, edhe kjo nuk ka pasur sukses. Pastaj pjesa e turizmit është shfaqur si problem ku ka zero të hyra, pastaj edhe drejtoria e Inspektionit dhe e Bujqësisë kanë qenë më të atakuarat nga ky plan, ka pasur mungesë të fushatës së vetëdijesimit, mosfunksionimi i zyrës ligjore brenda drejtorisë së Inspektoriatit pra kanë dalë mangësi nga ky plan. Te Arsimi, meritokracia, transparenca edhe raporti e ka gjetur që ka mos transparencë dhe jo gjithmonë meritokracia triumfon. Te Administrata kemi parë që ka pasur gjetje të përdorimit të paautorizuar të automjeteve të administratës. E përmenda edhe një herë bujqësinë, kriteret jo të qarta të hapjes së subvencioneve, nuk ka pasur transparencë të mjaftueshme, kështu ka gjetur ky raport. Këto janë disa nga pikat që i kam parë i kisha ftuar drejtorët ose nënkryetarin të përgjigjen për mos respektimin e këtyre çështjeve. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Agron! Fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- sqaron dhe përgjigjet në pyetje.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! Fjalën e ka drejtori Astrit Hajrizaj.

Astrit Hajrizaj- përshëndet të pranishmit dhe përgjigjet në pyetje dhe sqaron.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- i thashë edhe drejtorit, kjo është formë e raportimit edhe ata i kanë pasur gjetjet e veta, nuk d.m.th që është transparencë vetëm që e ka publikuar, mundet me qenë që nuk është transparencë për një kriter të caktuar, te drejtoria e bujqësisë kanë qenë edhe njëzet gjetje tjera. E kemi pjesën e dukurive negative, siç janë mbrojtja e pyjeve ku unë kam bërë thirrje para dy muajsh që të bëhet një zgjidhje për lauristë, sepse shkoi dimri dhe askush nuk e sheh askënd çfarë po bën në bjeshkët tona. Janë gjetje që i flet raporti e që i kemi folur edhe ne. Sa i përket pjesës ekonomike, drejtori e përmendi fabrikën, por Istogu nuk është vetëm ajo fabrikë, i ceka më lartë se cilat ishin gjetjet. Siç kam thënë me herët që buxheti ka qenë vetëm asfalt edhe raporti është ashtu. Nuk ka përkrahje.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Astrit Hajrizaj.

Astrit Hajrizaj- po flas pak për temën e dëmtimit të pyjeve, jemi në fazën përfundimtare të bartjes së kompetencave nga komunat në Agjencinë Pyjore, d.m.th ka kaluar ligji që ja kalon edhe kompetencat, në momentin që kalojnë kompetencat te një institucion tjetër ne nuk kemi mundësi me zhvilluar procedurë me rekrutuar staf. Ne mundësitë tona i kemi shfrytëzuar përmes zyrës së prokurimit ku e kemi pranur një staf profesional me kohë të caktuar të cilëve ju kanë skaduar kontratat dhe nuk kemi mundësi me i punësuar ata persona. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- e dëgjova drejtorin me vëmendje, unë edhe kur e kam bërë kërkesën, e di që ka qenë ai problem dhe kanë qenë gjashtë ose nëntë lauristë që i kanë kërkuar më herët. Komuna i ka pritur në takim ata se unë ju kam thënë me u takuar me kryetarin por nuk është bërë asnjë zgjidhje. Këto gjërat e Agjencive shkojnë me vite të tëra. Qëllimi im dhe i pyetjes time është,

pylli po shkatërrohet, me e bërë një zgjidhje me u takuar me ata njerëz, laurat janë pa njerëz, tek e fundit me e marrë një punëtor teknik, se degradimin e pyjeve nuk mund ta kthejmë më.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka nënkryetari i komunës.

Nënkryetari i komunës- deri sa ka qenë kompetencë e jona i kemi marrë ata me kontratë mbi vepër, me procedurë të prokurimit ka qenë kontratë njëvjeçare ajo është skaduar dhe tani bazuar në ligjin që është nxjerrë në Kuvendin e Republikës së Kosovës për pyjet, kalojnë në kompetencë të Agjencionit të Pyjeve, i cili operon përmes zyreve rajonale dhe mbi bazën e kësaj ne nuk kemi mundësi edhe nëse duam që ti zhvillojmë procedurat, e kemi konsultuar edhe sektorin ligjor, është e pamundur të rekrutojmë staf për menaxhimin e pyjeve. Sa i përket gjetjes të fusha e bujqësisë që nuk ka filluar ende, ne e kemi kontraktuar një kompani për mbikëqyrjen e projekteve kapitale, ku përmes saj formojmë edhe komisione për mbikëqyrjen e këtyre projekteve. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- a dëshiron edhe dikush ta marrë fjalën rreth kësaj pike? Po konsideroj që jo. Ju falënderoj të gjithëve për pyetjet përgjigjet!

Shqyrtimi i pikës 8.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka nënkryetari i komunës.

Nënkryetari i komunës- edhe për këtë pikë e keni pranuar materialin, nëse keni pyetje apo diçka urdhëroni.

Kryesuesi i Kuvendit- a dëshiron dikush me e marrë fjalën? Po konsideroj që jo. Ju faleminderit!

Shqyrtimi i pikës 10.

Kryesuesi i Kuvendit- ja u kemi shpërndarë dokumentin që na e ka kthyer MAPL-ja, në rishqyrtim edhe pse e ka dhënë pëlqimin paraprakisht, janë disa gabime teknike që i kemi bërë ne, janë çështje të datave të hapjes në ligje në nene. Është përdorur fjala 'hartat' jo 'harta' sepse është një hartë zonale. Ne e kemi miratuar me 28.12.2023 këtu me pëlqimin e ministrisë 2023-2031, viti 2023 është i eksploruar kështu që me e miratuar një vit pas, na kanë sugjeruar në ministri që të ja ndërrojmë emrin dokumentit dhe të thirret për vitet 2024-2032. Unë mund ta hapi debatin, fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Sa i përket Hartës Zonale tashmë është vonuar së tepërmi dhe është në dëm të të gjitha grupeve të interesit. Kësaj radhe po thuhet që është gabim teknik, mirëpo ky gabim qoftë edhe teknik duhet ta dimë që prodhon efekte juridike. Në mbledhjen e kaluar e kam pyetur kryetarin a i lexon vendimet që i nënshkruan sepse i ke edhe përgjegjësitë, duke që jo sepse këto gabime teknike po jaë shumë të shpeshta. Gjithashtu siç e pashë unë nuk ka vetëm gabime teknike por ka edhe thirrje në ligje dhe udhëzime jo adekuate. Shpresoj që nuk do të na kthehet prapë në rishqyrtim. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- për vonesën nuk e di kush e e ka fajin Niman, ne kemi qenë personalisht kemi biseduar e kemi marrë sugjerimin e tyre. Janë lëshuar gabime teknike, mund të ndodhin ato, edhe këto unë i kam nënshkruar jo kryetari. Nuk është ndonjë problem shumë i

madh, ju kisha ftuar ta votojmë Hartën Zonale të komunës së Istogut, është në të mirë të të gjithë qytetarëve. Kush është që të votohet?

Konstatojmë që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 25 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet Rishqyrtimi i Vendimit të Hartës Zonale të Komunës së Istogut 2024-2032.

Shqyrtimi i pikës 11.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka nënkryetari i komunës.

Nënkryetari i komunës- raportin e keni para jush, është raport i punës i Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve-Istog. Ky raport përmes përfshirjes si indikatorëve ndikon në grantin e performancës, nëse ka dikush diçka urdhëroni.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- nëse është siç po thotë nënkryetari vetëm për performancën ndoshta mundemi ta lëmë e dalim mirë por ky raport nuk është për mua raport, po na tregon që kanë mbajtur një takim me 01.12.2022 edhe kanë vendosur me e themeluar, është mbajtur një mbledhje tjetër me 03.03.2023, është themeluar ekipi, mbledhja tjetër 21.09.2023 është bërë njoftimi i ekipit, është mbajtur mbledhja tjetër me 03.10.2023, takim për qëllim të hartimit të punës së ekipit, ndërsa me datë 09.11.2023 takim për promovimin e ekipit. Këtij nuk mundem t'i them raport për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, që është gjetur ndonjë shkelje e të drejtave apo që është ndërmarrë diçka. Faleminderit shumë!

Kryesuesi i Kuvendit- ne tetor shumë vonë është miratuar ky plan. Mbahen shumë takime edhe aktivitete për të drejtat e fëmijëve, e kemi zyrtaren këtu, nëse ka diçka të shtoj le të urdhëron. Fjalën e ka Vlora Gjoci, zyrtare për të drejtat e fëmijëve.

Vlora Gjoci- përshëndet të gjithë të pranishmit dhe prezanton Raportin Vjetor të Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve-Istog.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit shumë Vlora! Fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- ekzaminimi ishte i kësaj që e lexuam që janë mbajtur këto mbledhje. Nuk na treguan çfarë është bërë për të drejtat e fëmijëve. Prej vitit 2022 ka filluar kjo, ende nuk kanë filluar me punë.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka nënkryetari i komunës.

Nënkryetari i komunës- profesor, besoj që me sqarimet e Vlorës i more përgjigjet dhe arsyetimet e nevojshme. Për me e bërë një raport ashtu siç po e kërkon ti se çfarë ka bërë ky ekip është prej vitit 2024, kështu që në fund të vitit apo fillim të vitit 2025 do ti kesh të gjitha aktivitetet që janë ndërmarrë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- pyetje apo diskutime tjera lidhur me këtë pikë a ka? Po konsideroj që jo. Faleminderit të gjithëve!

Shqyrtimi i pikës 12.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka nënkryetari i komunës.

Nënkryetari i komunës- raportin e keni pranuar të gjithë, është raport në pika të shkurta se çfarë është bërë rreth punës në realizmin e Planit të Veprimit për Transparencë komunale në kuadër të Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore për komunën e Istogut, nëse ka diskutime jemi këtu.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Floriana Maxharraj.

Floriana Maxharraj- përshëndet të gjithë të pranishmit! E kemi lexuar me vëmendje Planin për Trashëgiminë Kulturore dhe Natyrore për komunën e Istogut 2023-2027. Duke e ditur rëndësinë dhe vlerën e trashëgimisë kulturore, gjatë leximit do shohim se raporti është i mangët, më shumë duket një plan ideor se sa strategjik, po flasim për një temë goxha të ndjeshme për një plan katërvjeçar, që është i mbuluar vetëm me tri faqe. Kam disa pyetje për ekzekutivin, si mendoni ti arrini objektivat e përgjithshme që janë të paraqitura në këtë plan? Sa është punuar në identifikimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në komunën e Istogut gjatë mandatit dyvjeçar? Nëse ka identifikime cilat janë ato? Sipas disa informacioneve jo zyrtare thuhet që rrethojat që janë vendosur në bregun e kishës në Studenicë do të largohen? A ka pasur leje që janë vendosur këto rrethoja dhe a do të largohen? Besoj që një sqarim për këtë çështje do të ishte i mirë për neve dhe për juve. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- nënkryetari e ka fjalën.

Nënkryetari i komunës- një sqarim, ky nuk është plan strategjik por është raport i punës mbi Planin Strategjik për Trashëgiminë Kulturore dhe Natyrore për komunën e Istogut. Plani është miratuar në vitin 2023, në atë kohë besoj janë bërë analizat dhe janë bërë sugjerimet e nevojshme është aprovuar në këtë Kuvend, pra nuk është plan por raport i punës. Sa i përket rrethojës, te gjetjet arkeologjike që janë në fshatin Studenicë dhe Vrellë kanë qenë projekte kapitale që janë miratuar po në këtë Kuvend, ndërsa për pjesë të tjera të diskutimit ne nuk kemi informatë që ato do të hiqen, por nëse ka gjëra të tjera që ne nuk i dimë, mundemi i diskutuar dhe me e parë se për çfarë bëhet fjalë.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit nënkryetar! Fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- edhe unë e kam parë këtë Plan Strategjik se nënkryetari po i thotë raport, është i cekur si Plan Strategjik, nuk mundet me qenë raport se nuk është i viteve të kaluara. Nuk është as raport as plan, nëse është raport ishte dashur në detaje me treguar se çfarë është bërë për vitin 2023, po i tregon objektivat që kanë me u bërë. Është Plan Strategjik. E ke vetëm një objektiv të vendosur që është primare që është mbrojtja e vlerave resurseve natyrore këtë e kemi obligim, asnjë plan nuk tregon si don me e zhvilluar turizimin, zero investime në turizëm, me e zhvilluar edukimin për gjeneratat e reja, me ndërtuar guida me i pasur turistët me e parë se ku kanë me vizituar, trajnimet, ciceronët, trajnimin e stafit profesional etj. Nuk po shohim asnjë Plan Strategjik e as raport. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka nënkryetari.

Nënkryetari i komunës- e thashë edhe në fillim nuk është Plan Strategjik se është votuar në vitin e kaluar, është raport që është përmbledhur në pjesë të këtij raporti. Pjesën e aktiviteteve e ke parë, a është dashur të jetë ende më në detaje, është kritikë e juaja nuk e kundërshtoj. Po pjesa tjetër është e pasqyruar se çfarë është bërë në fushat e trashëgimisë. Ky nuk votohet është raport.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- këtu nuk po tregohet asgjë, përveç këtyre katër pikave që janë si objektiva, nuk është raport sepse nuk po raporton asgjë, pika është raporti e këtu po shkruan Plani Strategjik.

Kryesuesi i Kuvendit- raporti i Planit Strategjik për Trashëgiminë Kulturore.

Agron Gashi- ku është raporti? Këtu po shkruan Plani Strategjik. Analiza ime është shumë e qartë, nuk mundesh me më thënë është raport se nuk është. Nëse përmend objektiva nuk është raport. Tregomë me dy fjalë çfarë është raportuar në këtë raport për punën e turizmit dhe kulturës?

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- unë e kisha pasur një propozim dhe kisha dashur me e hedh në votim se nuk po i hedh kur po i propozoj kryesues. Nënkryetari po thotë është raport, këtu po shkruan plan. Së pari është me shumë gabime, e dyta përsëriten fjalët e njëjta, është maltretim dhe ofendim për Kuvendin që e keni sjellë këtë, tani ose thuani raport ose plan. Unë kisha kërkuar që të hiqet kjo pikë e rendit të ditës dhe të bëhet ose raport ose plan dhe të vjen në mbledhjen tjetër. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendi- fjalën e ka Hajrush Shoshi

Hajrush Shoshi- nëse themi që është raport i mangët është. Është raport i realizimit të planit strategjik, dhe në fund i kemi objektivat e përgjithshme, janë bërë dy konservime të objekteve të trashëgimisë kulturore. Edhe ky është një lloj raporti, këto dy punë janë kryer. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- kjo është votuar shumë vonë në Kuvend. Çdo fillim është i vështirë për realizimin e këtyre objektivave. Është shumë me rëndësi emërimi i pikës së rendit të ditës. Është raporti i Planit Strategjik, mos të keqkuptohemi. A dëshiron edhe dikush të diskutoj rreth kësaj pike? Florin Dreshaj e ka fjalën.

Florin Dreshaj- pika po shkruan raporti i planit strategjik, unë po propozoj që të shtyhet për mbledhjen e ardhshme kjo pikë dhe të definohet a është plan a raport.

Kryesuesi i Kuvendit- kush është që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj për mbledhjen e ardhshme me një raportim tjetër të kësaj pike?

Konstatojmë që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 11 vota për 14 kundër dhe 0 abstenim nuk kalon propozimi i anëtarit të Kuvendit Florin Dreshaj.

Shqyrtimi i pikës 13.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka menaxheri i kompanisë “Ambienti” Alferd Tahirsylaj.

Alferd Tahirsylaj- përshëndet të gjithë të pranishmit dhe prezaton pikën e rendit të ditës ‘Raporti i punës së KRM Ambienti, Njësia Operative Istog (janar-dhjetor) 2023.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit! Fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! E kam lexuar raportin e KRM “Ambienti” dhe thuhet që i kanë bërë sensibilizim popullatës për mbrojtjen e ambientit. Desha ta di çfarë sensibilizimi, a kanë mbajtur takim me qytetarë, apo kanë shpërndarë broshura, mirëmbajtjen e deponisë në Tuqep thuhet që e e mirëmban një kompani që e ka kontraktuar komuna, mirëpo gjatë muajve maj dhe qershor këta e kanë kontraktuar një kompani tjetër me vlerë 12.886.00 euro, arsyen pse e kanë ndryshuar kompaninë? Edhe te të tjera dhe gjobat, 3634.00 euro desha ta di për çfarë gjobave bëhet fjalë? Faleminderit!

Alferd Tahirsylaj- deponinë e kemi mirëmbajtur ne sepse i ka kaluar tenderi komunës, pra ka mbetur pa tender, dhe është dashur të mirëmbahet. Te sensibilizimi, kemi pasur takime pothuajse ditore, kurse te gjobat, janë gjoba të trafikut, për deponinë nga inspektorati i ministrisë kaq.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Andi Xhuraj.

Andi Xhuraj- unë e kam një pyetje, në raport e kanë cekur, arsyet e tjera të largimit të kontejnerëve janë se veprimtaria primare e kompanisë është bartja e mbeturinave të amvisërisë nëpër kontejnerë kanë hudhur mbeturina të ndërtimtarisë që kanë paraqitur problem për punëtorët dhe makineritë duke na shkaktuar defekte të shumta. Gjithashtu kanë hudhur mbetje shtazore që kanë paraqitur rrezik për punëtorët për ndonjë infeksion. Pyetja ime është, me largimin e kontejnerëve që e kanë bërë a mendojnë që kanë bërë zgjidhje, për shkak se nëse ato mbeturina të ndërtimtarisë dhe mbetjet shtazore janë hudhur në kontejnerë tani hudhen në tokë. Me e parë kompleksin banesor në qendër është e tmerrshme, është ngritur si shqetësim edhe prej koleges Lavdijes kjo çështje. Nëse i kanë parë këto pse nuk e kanë lajmëruar inspektoratin por kanë vendosur me i hequr kontejnerët.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e Alferd Tahirsylaj.

Alferd Tahirsylaj- gjendja është e njejtë aty si me kontejnerë si pa kontejnerë. Nuk është problemi te kompania, por te ajo pjesë e banorëve.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Andi Xhuraj.

Andi Xhuraj- po e shoh se qenka përgatitur sepse po e shoh në foto po atë pjesë. Po nëse shkojmë ne tani dhe e shohim po këtë pjesë a është në gjendje të pastër?

Alferd Tahirsylaj- po është e pastër. Ajo pjesë shtatë herë në javë pastrohet.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Haki Podrimaj.

Haki Podrimaj- e kam lexuar raportin, edhe vitin e kaluar kam qenë pak kritik sepse ja u kam kërkuar raportin në forma tabelare për tri vitet e fundit, për shpenzime, për inkasime edhe për sasinë e mbeturinave të bartura në depo, që ta dimë se ku po shkon ndërmarrja. Ju na keni dhënë vetëm për vitin e fundit, këtë radhë keni kursyer shumë gati në të gjitha digasteret. Por herën tjetër tu kisha lutur që të na sjellësh në formë tabelare të tri viteve të fundit që ti kemi parasysh.

Alferd Tahirsylaj- jep sqarim.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- unë desha të lidhem me kontejnerët në qendër aty sepse aty e kam banesën. Desha të them që prej se janë hequr ata kontejnerët e mëdhenjë vazhdimisht hudhen mbeturina por jo nga banorët sepse aty të gjitha bizneset e qendrës i hudhin mbeturinat, banorët tani e kanë nga një kontejnerë të vogël të hyrja, drejtori e din që duhet çdo ditë të pastrohet, për këtë arsye duhet të bëhet një zgjidhje sepse janë edhe bizneset.

Alferd Tahirsylaj- jep sqarime.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- sa i përket gjendjes në terren të KRM “Ambienti” jam i kënaqur personalisht që ka shkuar mirë deri tash, por i kam disa pyetje sa i përket shpenzimeve të pagave, dhe në bazë të fitimit që e kam parë që ka gjeneruar këtë vit por ishte në bazë të ndryshimit mes inkasimit dhe shpenzimeve diku 143.000.00 euro. Pyetja për drejtorin është kur e keni në plan që me i ngritur pak rrogat meqë të hyrat janë koxha të mëdha? Pyetja tjetër është te specifikimi i shpenzimeve te numri 24 pagesë për shërbimet e menaxhmentit 3.000 euro. Unë nuk po e kuptoj se çfarë hyn te këto shpenzime në ka mundësi me na treguar? Edhe pyetja e fundit, nuk e pashë që na ka kthyer Peja huazimin prej 10.000 eurove që ja kemi dhënë vitin e kaluar dhe drejtori ka pas premtuar që kanë me na kthyer. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Niman! Fjalën e ka Alferd Tahirsylaj.

Alferd Tahirsylaj- ky fitim ka mbetur sepse nuk ka pasur mundësi të kryhen procedurat, se kemi mbetur pas me realizmin e planit të biznesit për realizim të investimeve kapitale edhe për gjëra të tjera. Kas pasur ngritje të shujtave, të kthimi i borxhit, kësti fundit është kthyer me datë 24.01.2024 pra jemi mirë në këtë pjesë dhe i kanë kthyer mjetet. Pagesat e shërbimeve të menaxhmentit janë pagesa që bëhen në nivel regjional për stafin menaxhues sidomos për procedurat e prokurimit, zyra ligjore dhe zyra e auditimit. Sa i përket ngritjes së pagave nuk mundem të them që po ose jo, sepse nuk varet prej meje, varet prej nivelit regjional, në diskutim jemi por kur ndodhë nuk mundem të them diçka konkrete.

Kryesuesi i Kuvendit- a e dëshiron edhe dikush fjalën? Po konsideroj që jo. Ju falënderoj!

Shqyrtimi i pikës 14.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori i Shërbimeve Publike Abedin Kabashi.

Abedin Kabashi- përshëndet të gjithë të pranishmit dhe prezanton pikën e rendit të ditës Realizimi i planit, Objektivat e menaxhimit të mbeturinave dhe Plani operacional 2023.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! E hapim debatin rreth kësaj pike? A dëshiron dikush të diskutoj rreth kësaj pike të rendit të ditës? Po konsideroj që jo. Ju falënderoj!

Shqyrtimi i pikës 15.

Kryesuesi i Kuvendit- fjala është për ju nënkryetar!

Nënkryetari i komunës- fjala është për drejtorin Abedin Kabashi.

Abedin Kabashi- prezanton pikën e rendit të ditës 'Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së KRM Ambienti, Njësia Operative Istog, për ngritjen e çmimit të shërbimit të grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! Fjalën e ka kërkuar Agron Gashi.

Agron Gashi- e kemi parë këtë kërkesë edhe pse e dimë që është pak e vështirë edhe për kompaninë edhe për xhepin e qytetarëve, e kemi diskutuar edhe me drejtorin që të dhëna të sakta nuk kemi, mirëpo kjo çështje le të mbetet në dorën e kuvendarëve. Këtu janë shpenzuar mjete për ndërtimin e asaj deponie do kishte qenë mirë të diskutojmë edhe me ministrinë e jo me ardhur ne në këtë pjesë tani të kalojmë atje në Sferkë. Pra ajo është çështje e kryer, dënimi ka ardhur, ne kemi pasur ankesa edhe me herët për menaxhim të saj. I përmendi drejtori edhe komunat tjera, ata janë mundur me ju bërë zgjidhje qytetarëve në forma të ndryshme duke mos ju kërkuar ato të holla, ku vitin e kaluar ja u kemi kërkuar një (1) euro më shumë. Është ndërmarrje ndër më të mirat, raporti është i mirë, por tani unë jam që komuna me i subvencionuar qytetarët me atë pjesë që e sjellë raportin sa ka shpenzime për ato derivate që i ka. Mendoj që me ja dhënë një mundësi kësaj kompanie me ja ndarë komuna e mos me e prek xhepin e qytetarëve këtë herë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- a keni pasur ndonjëherë ndonjë raport që ajo deponi është e rrezikuar të mbyllet dhe a keni kërkuar raport prej ministrisë së Ambientit pse nuk e ka pasur ndonjë afat më vonë, e sa i përket ngritjes edhe vitin e kaluar kur e kemi ngritur një (1) euro unë personalisht kam qenë që mos me e ngritur, arsyeja është që një pjesë bukur e madhe e qytetarëve nuk kanë duke i marrë parasysh kostot tjera. Por meqë kemi ardhur në këtë situatë nuk kemi rrugëdalje tjetër se mbeturinat duhet me i larguar, pajtohem me Agronin që tha me pas mundësi me e subvencionuar qytetarin komuna, sa do që caktohet çmimi se u pa edhe te ndërmarrja shpenzimet janë rritur, këto e arsyetojnë ngritjen e çmimit, por si me pas mundësi me e gjetur rrugëdaljen që me i ndihmuar qytetarët. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori.

Abedin Kabashi- jep sqarime.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- fjalën e ka Niman Beqiraj. KRM “Ambienti” sigurisht që ka përformuar mirë edhe në terren mirëpo edhe financiarisht, ashtu siç e kemi parë edhe e vlerësojmë. Diferenca mes shpenzimeve edhe inkasimit ishte 143.000.00 euro këtë vit. Andaj nuk e shohim të arsyeshme ngritjen e çmimit edhe më tej meqë prej ardhjes së kryetarit të ri është shtrenjtuar për 35% prej 4.6 tani po kërkohet të bëhet 7. Ndërrimi i lokacionit për në Sferkë sigurisht që kërkon shpenzime shtesë, mirëpo prapë këto janë të mbulueshme me të hyrat që ka, edhe arsyetimi për mbulim të shpenzimeve nga kjo ngritje pra nuk qëndron. Nëse dëshironi me këtë ngritje të përmirësoni shërbimin ose me i ngritur pagat për punëtorët sigurisht që do të ishte më e arsyeshme, mirëpo rritje për përfitime të kompanisë e cila gjeneron mjaftushëm është e panevojshme. Gjithashtu këtu përveç rritjes po kërkohet të bëhet prapë kontratë për mbulim të shpenzimeve për mirëmbajtje të hapësirave publike. Shpenzimet e mirëmbajtjes së deponisë ilegale që kanë qenë më herët nuk qëndrojnë pra kjo prapë e zvogëlon koston. Në qoftë se shihet se po fillon të ketë probleme KRM “Ambienti” këtu është asambleja dhe do ti marrë masat të arsyeshme dhe kemi për ta përkrahur. Andaj ne si grup do të votojmë kundër rritjes së çmimit dhe i ftoj edhe të tjerët kolegë të veprojnë kështu. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Niman! Fjalën e ka Haki Podrimaj.

Haki Podrimaj- asnjë këshilltarë që jemi këtu me dëshirën tonë me pas mundësi nuk e votojmë se direkt është i atakuar qytetari. Mirëpo e vetmja është që nuk kemi paraparë buxhet për subvencionim, këtu pyetja është a është më mirë që të ngritet një (1) euro apo as dy tre muajsh të falimentoj kjo ndërmarrje publike. Qytetari prapë kur te llogarit për dymbëdhjetë (12) euro për dikë janë shumë, jashtë vullnetit tonë kjo është domosdoshmëri që kërkohet të shtrenjtohet sepse të falimentoj edhe kjo kompani atëherë problem të ringjallet. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- nuk është lehtë të votohet ndryshimi sidomos sot kur të gjithë po e shohim krizën, mirëpo duhet të kërkojmë mirëkuptimin edhe të qytetarëve edhe të bizneseve edhe të të gjithëve që këtë një (1) euro ta ndajmë së bashku me kompaninë me kusht që edhe kryetari edhe ekzekutivi gjatë këtë viti të ndërmarrin diçka në lidhje me subvencionimin e kësaj kompanie me mjetet që sigurisht që do ta caktojnë shumën. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori.

Abedin Kabashi- përgjigjet në pyetjet.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- faleminderit drejtor për sqarimet! Është fat që këto shpenzime janë mirë por nëse e shohim nga ana tjetër, shpenzimet për mirëmbajtjen e deponisë ilegale tani hiqen më nuk kemi nevojë më për mirëmbajtjen e deponisë. E dyta është kontrata e re të cilën po kërkon njësia operative në Istog për mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe zgjerimin e tyre edhe këtu janë disa të hyra shtesë, gjithashtu diferenca që po thuani nuk është fitim 143.000.00 euro, kjo është fitim, se janë fitimi minus shpenzimet dhe mbetet fitimi. Tani aty a ke planifikuar të investosh ajo është diçka tjetër, mbetja është 143.000.00 euro është fitim, kjo kompani shihet që ka stabilitet ekonomik mundet ta mbajë vetën, mirëpo në të kaluarën gjithashtu jemi dëshmitarë që kanë marrë ndihmë pajisje prej organizatave, munden me tentuar me gjetur prapë, ne jemi këtu kurdo që e shohim që e kanë humbur hapin, kemi me i ndihmuar, pra nuk

qëndrojnë ato që rrezikon të falimentoj sepse pasi që nuk ka falimentuar Stacioni i Autobusëve e nuk falimenton as kjo.

Kryesuesi i Kuvendit- drejtori e ka fjalën.

Abedin Kabashi- nuk është problemi te falimentimi por te shërbimi të mos dobësohet.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Andi Xhuraj.

Andi Xhuraj- duke e marrë parasysh që është jetike për kompaninë kërkesa e KRM “Ambienti” ne si grup i PDK-së e votojmë për, por shpresojmë që vitin e ardhshëm mos të vijmë prapë me të njëjtat kërkesa. Edhe një kërkesë e kam, nëse kthehemi prapë në deponi komunale le të kthehen çmimet ashtu siç kanë qenë para ngritjes. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori

Abedin Kabashi- sigurisht që kur te bëjmë deponinë transfer, dhe çmimi do jetë i pranushëm.

Agron Gashi- e propozimin tim a do e hedhni në votim, për subvencionim? Le të na sqaroj drejtori, mos të mbetet, se edhe komunave tjera ju ka ardhur ad-hoc, nuk ka qenë planifikim. Është çështja që ti shtjerrim mundësitë, nëse duan ekzekutivi ju japim kohë edhe një muaj, po të jemi më transparent, të vijmë me raporte, por mos të votojmë vetëm ashtu. Faleminderit shumë!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori.

Genc Ademaj- jep sqarimet më në detaje dhe përgjigjet në pyetje.

Kryesuesi i Kuvendit- Agron pra nuk po e hedhim në votim. Edhe Nimanit desha të them që, pagat i kanë shumë të ulëta, pra për punën që e bëjnë vërtetë ke të drejtë plotësisht. Fjalën e ka Andi Xhuraj.

Andi Xhuraj- vetëm diçka shkurt. E kam vetëm një këshillë për drejtorin, që tjera herë kur ka kërkesa sidomos të këtij lloji sjelljen arrogante që e pati ndaj meje dhe kolegut mos të përsëritet më. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- a e dëshiron edhe dikush fjalën? Po konsideroj që jo, atëherë e hedh në votim, kush është për?

Konstatojmë që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 14 vota për 10 kundër dhe 1 abstenim miratohet kërkesa e KRM Ambienti, Njësia Operative Istog, për ngritjen e çmimit të shërbimit të grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave.

Shqyrtimi i pikës 16.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Andi Xhuraj.

Andi Xhuraj- e kam një propozim të miratohet në parim por emrat mos të vendosen sot por me i dërguar gjatë ditëve në vijim.

Kryesuesi i Kuvendit- nëse doni të thoni emrat në rregull është, nëse jo po e lë hapur, diskutoni. Fjalën e ka Haki Podrimaj.

Haki Podrimaj- nga LDK-ja propozojmë, për komisionin për ndarjen e bursave Njomza Demaj.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Nexhmedin Balaj.

Nexhmedin Balaj- nga AAK-ja propozojmë Agron Gashi.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- nga LVV propozojmë Florin Dreshaj.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me komisionin për ankesa ndaj ndarjes së bursave. Fjalën e ka Haki Podrimaj.

Haki Podrimaj- nga LDK-ja propozojmë, për komisionin për ankesa ndaj ndarjen e bursave, Arta Balaj.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- nga AAK-ja propozojmë Nexhmedin Balaj.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- nga LVV propozojmë Niman Beqiraj.

Kryesuesi i Kuvendit- ju faleminderit! Këta janë emrat nga Kuvendit, ekzekutivit i mbetet pjesa tjetër.

Shqyrtimi i pikës 17.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj-unë i kam disa pyetje, për drejtorin e Zhvillimit Ekonomik, gjatë vitit 2024 a do të jetë vit ku do të përfundon asfaltimi i rrugëve, ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimi publik në fshatin Uçë, Cerkozë dhe Zhakovë pasi që kemi kërkesa të vazhdueshme nga banorët për rrugë, trotuare etj. Kur do të asfaltohen rrugët në fshatin Rakosh lagjia “Brahimaj” dhe rruga që i lidhë lagjen “Jahaj” dhe “Idrizaj” Zhakovë? E kemi një kërkesë nga banorët e lagjes “Sadrija” pesë shtëpi të ndara nga fshati Cerkozë që kërkojnë shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në lagjen e tyre pasi që janë mbetur jashtë sistemit dhe asfaltimin e rrugës “Kroni i Blinit”. Rruga në fshatin Padalishtë lagjia “Ahmetaj”, rruga që e lidhë Dushkajen me Istogun e poshtëm e cila është me gjatësi 250 m, rruga nga shkolla e Uçës për fshatin Cerkozë. Rruga “Liridona” në Dubravë, rruga në lagjen “Shalaj” në Zallq, këto janë kërkesa që janë bërë nga banorët vitin e kaluar, por duan ta dinë saktë a do kryhen këtë vit. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- për të gjitha këto pyetje, kur të vjen në qershor Qarkorja e parë Buxhetore si bashku i caktojme prioritetet, edhe besoj që është koha e duhur që të bisedojmë për projekte kapitale, sa i përket kërkesave kur ti mbajmë dëgjimet publike në qershor tregoj të vijnë me propozime, disa prej tyre që i pashe veç janë në planifikim por nuk janë prej burimeve të sigurta, por figurojnë në listë. Kështu që për të qenë më konkret ju kisha lutur në qershor të vijnë dhe ti adresojnë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- desha ta di saktë këto kërkesa që janë bërë prej banorëve dhe janë miratuar prej Zhvillimit Ekonomik, ceket që do të asfaltohet në vitin 2024, ata nuk kanë nevojë më të bëjnë kërkesë.

Genc Ademaj- vetëm ta kemi parasysh, ka kërkesa të tilla që nuk janë lëshuar nga unë, janë kërkesa të vitit 2020-2021, pra kam pasur pasur kërkesa të tilla dhe kanë thënë që na është aprovuar por nuk ceket decidivisht që është e aprovuar, por ceket që do të hyj në prioritet.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Valbonë Demaj.

Valbonë Demaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! E kam një kërkesë prej nga Hendikos, kërkojnë një ndihmë për një kombi-bus që bën bartjen e fëmijëve me nevoja të veçanta, kanë ankesë që më shumë ky kombi-busi që e kanë rrin te mjeshtri sesa që është funksional, ai kombi-bus e bën bartjen e fëmijëve në qendër dhe anasjelltas. Janë falënderues për vitin e kaluar se e kanë bërë një kontratë dhe ju kanë ndihmuar për rehabilitimin e atyre fëmijëve psikofizik dhe psikologjik, mirëpo është kërkesë e tyre a mundet diçka komuna të ju ndihmoj në lidhje me atë kombi-bus. Është më tepër se 70% i shpenzuar. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- e kemi një bashkëpunim të mirë me ta i kemi përkrahur ndër vite, edhe këtë vit është planifikuar përkrahja për nevojat që i kanë. E kemi pasur temë diskutimi edhe çështjen e automjetit që e kanë në defekt.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Andi Xhuraj.

Andi Xhuraj- desha ta përgëzoj drejtorin e Administratës z. Arben Kabashi i cili ka dalur me performancë te katër komunat më të mira në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- unë i kam dy pyetje dhe dy kërkesa. Dy kërkesa vijnë nga banorët e fshatit Vrellë. Meqë tani kemi kaluar te varrezat e reja e kemi parë shumë të domosdoshme ndërtimin e një parkingu që ka hapësirë meqë pjesëmarrësit në varrim nuk kishin mundësi ku me i parkuar veturat. Kërkesa tjetër është një trotuar për shkak të hapësirës së madhe të varrezave, sepse në ditët me shi e kemi parë që është shumë problem të bartet i vdekuri deri të varri sepse është hapësira e madhe dhe toka e butë. Kurse dy pyetjet tjera janë për sheshin në Istog, janë bërë dy vite ende nuk kanë ardhur ulëset, kur do vijnë ato? Dhe pyetja tjetër është, a do

vendosen shportat e vogla për mbeturina në shesh sepse na rastis shpesh që me i mbajtur ato në dorë për shkak të pamundësisë ku me i hudhur. Dhe në këtë mënyrë të ja japim sheshit karakterin që e ka, sepse momentalisht përveç një bllokade e qendrës nuk është dipka më shumë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Abedin Kabashi.

Abedin Kabashi- sa i përket parkingut të varrezave, sa për fillim nuk është keq, por sigurisht kur të bëjmë kontratën për mirëmbajtjen e rrugëve e kemi mundësinë ta zgjerojmë. Ndërsa sa i përket ulsëve dhe kontejnerët, unë mendoj që shumë shpejt do të vendosen e pastaj do e shohim efektin e tyre.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Genc Ademaj.

Genc Ademaj- jep sqarime shtesë.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- një pyetje fillimisht e kam për ju, pyetjet që bëhen a evidentohen diku në mënyrë sistematike, se ka ndodhur në dy tri raste të njëjtat pyetje i kam bërë unë dhe anëtarët tjerë. Kishte me qenë mirë ta kemi evidencën një pyetje e cila ka marrë përgjigje, në mënyrë që të japet mundësia të bëhen pyetje tjera. Pyetja tjetër është a keni filluar të punoni diçka në lidhje me formimin e Këshillave të fshatrave, edhe pse është punuar shumë nuk ka asgjë në këtë drejtim. Edhe një pyetje tjetër, te sheshi te kjo rruga që është mbyllur, a ka pasur mundësi që kjo rrugë të hapet dhe të mbyllet me orë. Është kërkesë me kanë pyetur qytetarët. Kaq.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Andi Xhuraj.

Andi Xhuraj- unë desha të ndërlihem te profesoresha Ajshe, Nimani e bëri pyetjen për ulëse për shporta në sheshin e ri, unë këtë pyetje e kam parashtruar vitin e kaluar, por edhe nëse e bën Nimani tani po të njëjtën pyetje, ose në të ardhmen e bën p.sh kolegia Valbona, për mua nuk ka problem se sa më shumë presion ndaj ekzekutivit aq më mirë është sepse kryhen punët. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- ashtu siç jeni të njoftuar Rregullorja për themelimin e Këshillave të fshatrave është aprovuar vitin e kaluar edhe komisioni për përzgjedhje edhe orari është përcaktuar. Arsyeja pse nuk kemi mundur të fillojmë vitin e kaluar është sepse nuk kemi pasur buxhet të planifikuar, sepse rregullorja kërkon pagesën e kryetarëve të këshillave dhe tani e kemi ndarë buxhetin. Tani mbetet vetëm të publikohet njoftimi për orar dhe të organizohen zgjedhjet dhe është e planifikuar të bëhet brenda vitit.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Ardita Idrizaj.

Ardita Idrizaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Desha ta pyes drejtorin e Zhvillimit Ekonomik kur do filloj rregullimi i rrugës “Ledinat” në fshatin Lubozhdë, po ashtu desha ta pyes a pritët këtë vit të bëhet trotuarin dhe ndriçimin prej Lubozhdës deri në Vrellë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- për këtë vit nuk është prioritet rregullimi i rrugës sepse kanalizmi ende vazhdon, dhe në Lubozhdë si prioritet këtë vit do të jetë rruga në lagjen “Kadaj” dhe ajo rruga që e lidh memorialin është pak sfiduese sepse në gjendjen kadastrale figuron ashtu që na pamundëson realizimin e asaj rruge pa ardhur te një pëlqim te një shpronësimi në rast nevojë. Duhet të kontaktojmë me banorët aty a janë të pajtimit që një pjesë e rrugës që prek dy anët të lëshohen me mirëkuptim, sepse në kadastër është një gjendje jo e mirë. pra duhet të zgjidhet së pari kjo çështje pronësore. E sa i përket trotuarit është planifikuar të bëhet me asfalt, është te pjesa e prioritetit. Si pari duhet të merret pëlqimi nga ministria e besoj që një pjesë fillon këtë vit. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Andi Xhuraj.

Andi Xhuraj- e ceke më herët që drejtori i Shërbimeve Publike ka qenë më i atakuari sot, tani prej “atakimeve tona” dua ta ceku që është njëri ndër drejtorët që ka realizuar më së shumti projekte. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit

Falënderon të gjithë për durimin që patën, dhe kontributin e dhënë,
Uron të gjithëve një vit sa më të mbarë
E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.
Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 15:10.

**Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj**

**Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova**



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/MINISTRY OF HEALTH

S T A T U T I

I

QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE

STATUTE

of the

MAIN FAMILY MEDICINE CENTER

S T A T U T

GLAVNOG CENTRA PORODIČNE MEDICINE

Kompetencat e Kuvendit Komunal, Në mbështetje të nenit 45, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 04/L-125, dhe ne Udhëzimin Administrativ shendetesi 04/2020 KPSH. Miraton: STATUTIN E QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE Neni 1 I - Dispozitat e përgjithshme Me këtë Statut rregullohen: dispozitat e përgjithshme, emërtimi dhe selia, veprimtaria e QKMF-së, statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, struktura e institucionit, udhëheqja dhe trupat e institucionit, zhvillimi i vazhdueshëm institucional, mbikëqyrja e QKMF-së, aktet e përgjithshme të QKMF, pronësia dhe financimi, transparenca në punë, konfidenca profesionale dhe afariste, organizimi sindikal, mbikëqyrja e brendshme dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së kujdesit	Competencies of the Municipal Assembly, Pursuant to Article 45, paragraph 1 and 2 of Law No. 04/L-125 on Health, Adopts the following: STATUTE OF THE MAIN FAMILY MEDICINE CENTER Article 1 I – General provisions This Statute regulates: general provisions, designation and headquarter, activity of MFMC, legal status, representation and presentation, structure of the institution, leadership and bodies of the institution, continuous institutional development, supervision of MFMC, general acts of MFMC, ownership and financing, transparency at work, professional and business confidence, trade union organization, internal supervision and transitional and final provisions relating to the exercise of healthcare activity in the Main Family Medicine Center (hereinafter: MFMC).	Nadležnosti Skupštine Opštine, Na osnovu člana 45, stavke 1. i 2. Zakona o zdravlju br. 04/L-125, i na osnovu Administrativnog Uputstva 04/2020 za PZN . Usvaja: STATUT GLAVNOG CENTRA PORODIČNE MEDICINE Član 1 I - Opšte odredbe Ovim Statutom se uređuju: opšte odredbe, naziv i sedište, delovanje GCPM-a, pravni status, zastupanje i prikazivanje, struktura institucije, rukovodstvo i tela institucije, kontinuirani institucionalni razvoj, nadzor GCPM-a, opšti akti GCPM-a, vlasništvo i finansiranje, transparentnost u radu, profesionalna i poslovna poverljivost, sindikalno organizovanje, unutrašnji nadzor i prelazne i konačne odredbe u vezi sa sprovođenjem delatnosti primarne nege u Glavnom centru porodične medicine (u daljnjem tekstu: GCPM).
--	--	---

shëndetësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (në tekstin e mëtejme: QKMF). Neni 2 Statusi i QKMF 1.QKMF-ja ka statusin e personit juridik public ku organizohet, ofrohet dhe zbatohet Kujdesi Parësor Shëndetësor Publik (në tekstin e mëtejme: KPSH). 2.Themelues i QKMF-së është Kuvendi Komunal i Komunes së Istogut. 3.QKMF-ja ka filluar punën në vitin 1964. II - Emërtimi dhe Selia Neni 3 Emërtimi 1.Emri i institucionit është: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Istog. 2.Shenja njohëse e këtij institucioni është unike për të gjitha QKMF në Republikën e Kosovës dhe aprovohet nga Kuvendi Komunal, në bazë të procedurave ligjore.	Article 2 MFMC Status 1.The MFMC has the status of a public legal entity, having the quality of the employing authority, where the Public Primary Healthcare is organized, provided and implemented (hereinafter: PHC). 2.The founder of the MFMC is the Municipal Assembly of (the name of respective municipality). 3.The MFMC (the name of respective municipality) has started the work in(the year). II - Designation and Headquarter Article 3 Designation 1. The name of the institution is: Main Family Medicine Center in (the name of respective municipality). 2.The recognition mark of this institution is unique for all MFMC in the Republic of Kosovo and is approved by the Municipal Assembly, on the basis of legal procedures.	Član 2 Status GCPM 1.GCPM ima status javnog pravnog lica, u svojstvu autoriteta poslodavca, gde se organizuje, pruža i primenjuje Javna Primarna zdravstvena nega (u daljnjem tekstu: PZN). 2.Osnivač GCPM je Skupština opštine Istok. 3.GCPM u Istok je počeo sa radom 1964 godine. II – Naziv i Sedište Član 3 Naziv 1.Naziv institucije je: Glavni Centar Porodične Medicine u Istok-u. 2.Identifikacioni znak ove ustanove je jedinstven za sve GCPM u Republici Kosovo i usvaja se od Skupštine opštine, na osnovu pravnih procedura. 3.Naziv GCPM-a, CPM-a i APM-a mora biti jasno nadpisan na ulazu dotične zdravstvene ustanove PZN-a.
--	---	--

3.Emërtimi i QKMF, QMF dhe AMF duhet të jetë i mbishkruar qartë në hyrje të institucionit shëndetësor përkatës të KPSH. 4.Për ndryshimin e selisë së QKMF vendos themeluesi, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Shëndetësisë. Neni 4 Selia Selia e QKMF në Istog gjindet në Istog rr.Mullinjet e Istogut nr.50. Neni 5 Vula 1.QKMF posedon vulën e saj që në qarkullimin juridik paraqitet si Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare. 2.Vula është në formë të rrumbullakët dhe ka dimension 3.5 cm (35 mm). 2.1. Rrethi i parë: Republika e Kosovës; 2.2. Rrethi i dytë: Komuna Istog; 2.3. Rrethi i tretë: QKMF në Istog; 2.4. Në mes të vulës është logoja unike për të gjitha QKMF në Republikën e Kosovës. 3.QKMF posedon vulën katrore, me dimensione 5.5 cm x 3 cm, që përmban emërtimin, selinë dhe hapësirën për	3.The name of MFMC, FMC and FMA should be clearly indicated at the entrance of the respective health institution of PHC. 4.Changing of the MFMC headquarter shall be decided by the founder, upon obtaining the consent of the Ministry of Health. Article 4 Headquarter The MFMC headquarters in (the name of the respective municipality) is located at (the address where the MFMC is located). Article 5 Stamp 1.MFMC possesses its stamp, which in the legal circulation is presented as the Main Family Medicine Center. 2.The stamp is of round shape and has a dimension of 3.5 cm (35 mm). 2.1. First circle: Republic of Kosovo; 2.2. Second circle: Municipality (the name of respective municipality); 2.3. Third circle: MFMC in (the name of respective municipality);	4.Za promenu sedišta GCPM-a odlučuje osnivač, nakon dobijanja pristanka od Ministarstva zdravstva. Član 4 Sedište Sedište GCPM-a Istok se nalazi u Ul. Mullinjet e Istogut br. 50. Član 5 Pečat 1.GCPM ima svoj pečat koji se u pravnom protoku predstavlja kao Glavni centar porodične medicine. 2.Pečat je okruglog oblika i dimenzija 3.5 cm (35 mm). 2.1. Prvi krug: Republika Kosovo; 2.2. Drugi krug: Opština Istok; 2.3. Treći krug: GCPM u Istok-u; 2.4. Na sredini pečata je jedinstveni logo za sve GCPM-ove u Republici Kosovo. 3.GCPM ima četvrtasti pečat, sa dimenzijama 5.5 cm x 3 cm, koji sadrži naziv, sedište i površinu za evidentiranje broja i datuma prijema dokumenta.
---	--	---

evidentimin e numrit dhe të datës së pranimit të dokumentit. 4.Vula duhet të përmbajë emërtimin e institucionit, sipas këtij Statuti dhe të jetë në gjuhët të cilat janë në përdorim zyrtar në Kosovë. 5.Për numrin e vulave, mënyrën e përdorimit dhe autorizimin e personit për përdorim dhe ruajtje vendos drejtori. 6. Çdo vulë ka numër identifikues. III-Veprimtaria, Shërbimet dhe Përfaqësimi i QKMF Neni 6 Veprimtaria 1.Veprimtaria e QKMF përfshinë ofrimin e shërbimeve shëndetësore në KPSH për popullatën e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare, në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës. 2.Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që të gjithë banorëve të Komunës së Istogut t'u ofrojë shërbime shëndetësore gjithëpërfshirëse, efikase dhe në vazhdimësi individit dhe familjes në të gjitha fazat e jetës, bazuar në të	2.4. In the middle of the stamp stands the unique logo for all MFMCs in the Republic of Kosovo. 3.MFMC possesses the square stamp, of dimensions 5.5 cm x 3 cm, which contains the name, headquarter and space for recording the number and date of the receipt of document. 4.The stamp must contain the designation of the institution and according to this Statute must be in the languages, which are in official use in Kosovo. 5.The number of stamps, the manner of using the stamp and authorizing of persons for using and preserving the stamp shall be decided by the director. 6. Each stamp has an identification number. III-Activity, Services and Representation of MFMC Article 6 Activity 1.The activity of MFMC includes the provision of health services in PHC for the population of the municipality, as an activity of special interest, through the implementation of the	4.Peçat treba da sadrži naziv institucije, prema ovom Statutu, i da bude na jezicima koji su u službenoj upotrebi na Kosovu. 5.O broju pečata, načinu korišćenja i o ovlašćenom licu za korišćenje i čuvanje odlučuje direktor. 6. Svaki pečat ima identifikacioni broj. III-Delatnost, usluge i zastupanje GCPM Član 6 Delatnost 1.Delatnost GCPM-a obuhvata pružanje primarnih zdravstvenih usluga u PZN-u za stanovništvo opštine, kao delatnost od posebnog interesa, kroz primenu koncepta porodične medicine, u okviru jedinstvenog zdravstvenog sistema Kosova. 2.Koncept porodične medicine se sastoji u tome da se svim stanovnicima opštine Istok pružaju sveobuhvatne i efikasne zdravstvene usluge, u kontinuitetu, pojedincu i porodici u svim životnim etapama, na osnovu naučnih podataka, kroz određivanje porodičnog lekara, koji će biti ulazna kapija za sve one koji
---	--	--

dhëna shkencore, përmes mjekut familjar si mjek i përzgjedhur i cili do të jetë portë hyrëse për të gjithë kërkuesit e shërbimeve në sistemin shëndetësor dhe njëherit pikë referuese për specialistët konsultantët në KPSH dhe në nivelet tjera të kujdesit shëndetësor. 3.Sipas SSSH 2017-2021 dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, ekipi i mjekësisë familjare i përbërë nga një mjekë familjar dhe dy infermiere familjare ofron shërbime shëndetësore për 2000 banorë sipas shtrirjes territoriale, gjeografike dhe organizimit të QKMF. 4.Standardet në mjekësinë familjare sipas këtij statuti, do t'i nënshtrohen revidimit periodik nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. 5.Shërbimet shëndetësore në QKMF -Istog sigurohen dhe zbatohen nga profesionistët shëndetësor të cilët i plotësojnë kriteret e parapara në Ligjin për shëndetësi: 5.1. Specialist i Mjekësisë Familjare; 5.2. Doktor i Mjekësisë; 5.3. Doktor i Stomatologjisë; 5.4.Specialist i pedodoncisë dhe preventivës; 5.5. Farmacist i diplomuar – magjistër i farmacisë;	concept of family medicine, within the unique health system of Kosovo. 2.The concept of family medicine consists in provision of comprehensive, efficient health services to all residents of the Municipality of (the name of the respective municipality) and in continuation to individuals and families at all stages of life, on the basis of scientific data, through the family doctor as appointed doctor who will be the gateway for all service seekers in the health system and, at the same time, a reference point for specialist consultants in the PHC and other levels of health care. 3.According to HSS 2017-2021 and standards set by the Ministry of Health, the family medicine team consisting of a family doctor and two family medicine nurses provides health services for 2000 inhabitants according to the territorial, geographical area extent and organization of MFMC. 4.According to this statute the standards in family medicine will be subject to periodic review by the Ministry of Health 5.Health services in the MFMC in (the name of the respective municipality) are provided and implemented by health professionals who meet the criteria set out in the Law on Health:	zahtevaju usluge u zdravstvenom sistemu, i istovremeno referentna tačka za savetnike specijaliste u PZN-u i na ostalim nivoima zdravstvene nege. 3.Prema SZS-u 2017-2021, i standarda određenih od Ministarstva zdravstva, ekipa porodične medicine koja se sastoji od jednog porodičnog lekara i dve porodične medicinske sestre pruža zdravstvene usluge za 2000 stanovnika u zavisnosti od teritorijalnog i geografskog prostiranja kao i organizovanja GCPM-a. 4.Standardi porodične medicine prema ovom statutu će se podvrgavati periodičnom revidiranju od strane Ministarstva zdravstva. 5.Zdravstvene usluge u GCPM- Istok, se obezbeđuju i primenjuju od zdravstvenih profesionalaca koji ispunjavaju kriterijume predviđene Zakonom o zdravstvu: 5.1 Specijalista porodične medicine; 5.2. Zdravstveni lekar; 5.3. Lekar stomatologije; 5.4.Specijalista na pedodoncia i preventiva; 5.5.Diplomirani farmaceut– magistar farmacije; 5.6. Specijalista kliničke biohemije,
---	--	--

5.6. Specialist i Biokimisë klinike; 5.7. Infermier i/e diplomuar; 5.8. Mami e diplomuar; 5.9. Teknik laborant; 5.10. Teknik i farmacisë; 5.11. Teknik/asistent i stomatologjisë; 5.12. Radiologu dhe tekniku i radiologjisë në institucionet ku funksionon kabineti i Rtg; 5.13. Profesionistët shëndetësorë të tjerë me kualifikim të mesëm dhe të lartë, të përcaktuar në regjistrin zyrtar të Ministrisë; 5.14. Bashkëpunëtorët profesional me shqkollim jashtë lëmisë së mjekësisë, të evidentuar në regjistrin zyrtar me vendim të Ministrit të Shëndetësisë, në bazë të propozimit të Odës përkatëse të profesionistëve sipas Ligjit të Shëndetësisë. 6.Në QKMF ku funksionojnë maternitetet, është i domosdoshëm Gjinekologu dhe Neonatologu ose Pediatri. 7.Specialistët nga lëmitë e tjera, mund të vazhdojnë punën në KPSH si konsulent të Mjekëve Familjarë deri në pensionim.	5.1.Family Medicine Specialist; 5.2.Doctor of medicine; 5.3.Doctor of dentistry; 5.4.Specialist of pedodontology and preventive; 5.5.Graduated Pharmacist–Master of pharmacy; 5.6.Specialist in Clinical Biochemistry; 5.7.Graduated nurse; 5.8.Graduated midwife; 5.9.Laboratory technician; 5.10.Pharmacy technician; 5.11. Dentistry technician / assistant 5.12. Radiologist and radiology technician in the institutions where the Rtg cabinet is operational; 5.13.Medical professionals with a middle or high education, as defined in the official register of the Ministry of Health; 5.14. Other professional associates with non-medical education, registered in the official register by the decision of the Minister of Health, at the proposal of the respective Chamber of Health Professionals according to the Law on Health.	5.7. Diplomirani/a medicinska sestra; 5.8. Diplomirana akušerka; 5.9. Laboratorijski tehničar; 5.10. Farmaceutski tehničar, 5.11. Tehničar/asistent stomatologije, 5.12. Radiolog i radiološki tehničar u ustanovi gde funkcioniše Rtg kabinet; 5.13.Ostali zdravstveni stručnjaci sa srednjim i visokim kvalifikacijama, određenim u službenom registru Ministarstva; 5.14.Stručni saradnici sa školovanjem van oblasti zdravstva, evidentirani u službenom registru odlukom Ministarstva zdravstva, na osnovu predloga dotične Komore stručnjaka po Zakonu o zdravstvu. 6.U GCPM-u, gde funkcioniše materinstvo, neophodan je ginekolog i neonatolog ili pedijatar. 7.Specijalisti iz ostalih oblasti mogu da nastave rad u PZN-u kao konsultanti porodičnih lekara do penzionisanja. 8.Konsultant u PZN-u po stavki 3. ovog člana pružaju konsultativne usluge u GCPM-u i CPM-u.
---	---	--

8.Konsulentët në KPSH sipas paragrafit 3 të ketij Neni ofrojnë shërbime konsultative në QKMF dhe QMF. 9.Mjeku familjar duhet të jetë i certifikuar për të ofruar shërbime me Ultrazë. Neni 7 Shërbimet 1.QKMF kryen këto shërbime të kujdesit parësor shëndetësor: 1.1.Shërbimet e promovimit shëndetësor; përfshirë informimin, komunikimin dhe edukimin brenda institucioneve dhe në komunitet; 1.2.Shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit dhe shërbimet tjera parandaluese; 1.3.Shërbimet esenciale kurative dhe ndërhyrje të vogla kirurgjike; 1.4.Shërbime të kujdesit akut dhe urgjent; 1.5.Shërbimet e kujdesit shëndetësor për sëmundjet kronike; 1.6.Shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijë, adoleshentë dhe të rinjë; 1.7.Shërbimet e shëndetit riprodhues; 1.8.Shërbimet e shëndetit oral dhe parandalues; 1.9.Shërbimet e shëndetit mendor; 1.10.Shërbimet e kujdesit shtëpiak përfshirë shërbimet e kujdesit ndaj nënës	6.In a MFMC where maternity ward operates, a Gynecologist and Neonatologist or Pediatrician are required. 7.Specialists of other fields can continue working in the PHC as a family doctor consultant until retirement. 8.According to paragraph 3 of this Article, consultants in PHC provide consulting services in the MFMC and FMC. 9.The family doctor must be certified to provide Ultrasound services. Article 7 Services 1.MFMC provides the following primary healthcare services: 1.1.Health promotion services, including information, communication and education within institutions and in the community; 1.2.Immunization and vaccination services as well as other preventive services; 1.3.Essential curative services and minor surgical interventions; 1.4.Acute and emergency healthcare services;	9.Porodični lekar mora biti sertifikovan da bi pružao usluge ultrazvukom. Član 7 Usluge 1.GCPM obavlja ove usluge primarne zdravstvene nege: 1.1.Usluge zdravstvenog promovisanja, uključujući informisanje, komunikaciju i obrazovanje unutar ustanova i u zajednici; 1.2.Usluge imunizacije i vakcinacije i ostale preventivne usluge; 1.3.Esencijalne usluge lečenja i male hirurške intervencije; 1.4.Usluge akutne i hitne nege; 1.5.Usluge zdravstvene nege za hronične bolesti; 1.6.Usluge zdravstvene nege za decu, adolescente i mlade; 1.7. Usluge reproduktivnog zdravlja; 1.8.Usluge oralnog i preventivnog zdravlja; 1.9.Usluge mentalnog zdravlja; 1.10.Usluge kućne nege uključujući usluge nege prema majki i detetu, palijativna nega kao i kućna nega na osnovu potrebe stanovništva i prioriteta javnog zdravlja;
---	---	--

dhe fëmijes, kujdesi paliativ si dhe kujdesi shtëpiak bazuar në nevojat e popullatës dhe prioritetet e shëndetit publik; 1.11.Shpërndarjen e barërave nga lista esenciale. Neni 8 Përfaqësimi 1.QKMF në Istog është institucion, i cili bën pjesë në rrjetin e institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor publik në Republikën e Kosovës. 2.QKMF kryen dhe ofron shërbime të kujdesit parësor shëndetësor për qytetarët e komunës, sipas dispozitave ligjore që janë në fuqi. 3.Për nënshkrimin e kontratave, me të cilat fitohen, tjetërsohen apo shiten objektet dhe pajisjet kapitale, me ose pa vlerë rigjeneruese të QKMF-së, duhet të ketë së pari propozimin e menaxhmentit të QKMF dhe aprovimin e themeluesit, në bazë të ligjeve në fuqi. 4.Drejtori i QKMF-së ka të gjitha autorizimet për përfaqësimin juridik dhe afarist, brenda veprimtarisë së QKMF me pëlqim të Drejtoratit Komunal për Shëndetësi.	1.5.Healthcare services for chronic diseases; 1.6.Healthcare services for children, adolescents and young people; 1.7.Reproductive health-care services; 1.8.Oral and preventive health services; 1.9.Mental health services; 1.10.Home healthcare services including maternal and child care services, palliative care as well as home healthcare on the basis of the needs of population and public health priorities; 1.11. Distribution of medicaments from the essential list. Article 8 Representation 1.MFMC in (the name of the respective municipality) is an institution, which is part of the network of public Primary Healthcare institutions in the Republic of Kosovo. 2.MFMC carries out and provides primary healthcare services for the citizens of the municipality, pursuant to the legal provisions in force.	1.11. Raspodela lekova sa esencijalne liste. Član 8 Zastupanje 1.GCPM u Istok-u je institucija, koja je deo mreže javnih institucija Primarne zdravstvene nege, u Republici Kosova. 2.GCPM obavlja i pruža usluge primarne nege za građane opštine, prema zakonskim odredbama na snazi. 3.Za potpisivanje ugovora, kojima se stiću, otuđuju ili prodaju objekti i kapitalna oprema, sa ili bez regenerativne vrednosti GCPM-a, potreban je prvo predlog rukovodstva GCPM-a i saglasnost osnivača, na osnovu zakona na snazi. 4.Direktor GCPM ima sva ovlašćenja za pravno i poslovno zastupanje, unutar delatnosti GCPM uz saglasnost Opštinske Direkcije za zdravstvo i socijalnu zaštitu.
---	--	---

IV-Struktura e Institucionit në QKMF Neni 9 Organizimi i QKMF 1.QKMF me qëllim të ofrimit të përkujdesjes shëndetësore për banorët e vet, organizohet me këto njësi përbërëse: 1.1.Departmenti i Mjekësisë Familjare me këtë përbërje: 1.1.1.Sektori i Mjekësisë Familjare; 1.1.2.Njësia e SISH; 1.1.3.Njësia e Vaksinit dhe Imunizimit; 1.1.4.Sektori i Shëndetit Oral Preventiv; 1.1.5..Sektori i Kujdesit Urgjent; 1.1.6.Sektori konsultativë dhe Diagnostikë; 1.1.6.1. Sherbimet konsultative; 1.1.6.2 Kabineti Radiologjik; 1.1.6.3.Laboratori. 1.2.Departmenti i Administratës së QKMF-së Istog organizohet në: 1.2.1. Njësia ose Zyra e personelit; 1.2.2. Njësia ose Zyra Juridike; 1.2.3. Njësia ose Zyra për buxhet dhe financa; 1.2.4. Njësia ose Zyra për shërbime teknike.	3.For the signing of contracts, whereby are acquired, alienated or sold MFMC capital buildings and equipment, with or without regeneration value, first there is required a proposal by the management of the MFMC and the approval by the founder, based on the laws in force. 4.The Director of MFMC has all the authorizations for legal and business representation, within the activity of MFMC upon the consent of the Municipal Directorate of Health and Social Welfare. IV-Institution Structure in the MFMC Article 9 Organization of the MFMC 1.In order to provide healthcare for its residents, the MFMC is organized into the following constituent units: 1.1.Department of Family Medicine consisting of: 1.1.1.Family Medicine Sector; 1.1.2 HIS Unit; 1.1.3 Vaccination and Immunization Unit; 1.1.4 Oral Health Preventive Sector; 1.1.5 Emergency Healthcare Sector; 1.1.6 Consulting and Diagnostics Sector; 1.1.6.1. Consulting services;	IV-Struktura institucije u GCPM-u. Član 9 Organizovanje u GCPM 1.GCPM, u cilju pružanje zdravstvene nege za svoje stanovnike, organizuje se sastavnim jedinicama: 1.1.Odeljenje porodične medicine u ovom sastavu: 1.1.1.Sektor porodične medicine; 1.1.2.Jedinica ISZ-a; 1.1.3Jedinica vakcinacije i imunizacije, 1.1.4Sektor preventivnog oralnog zdravlja; 1.1.5.Sektor hitne nege; 1.1.6 Sektor za konsultaciju i Dijagnostika; 1.1.6.1. Konsultativne usluge; 1.1.6.2. Radiološki kabinet; 1.1.6.3.Laboratorija. 1.2.Odeljenje Administracije GCPM-a u Istoku organizuje se u: 1.2.1. Jedinica ili Kancelarija osoblja; 1.2.2. Jedinica ili Pravna kancelarija; 1.2.3. Jedinica ili Kancelarija za budžet i finansije; 1.2.4. Jedinica ili Kancelarija za tehničke usluge.
--	---	--

1.3.Barnatorja Qendrore: 1.3.1.Barnatorja qendrore është njësi organizative e QKMF e cila themelohet dhe funksionon sipas ligjeve dhe akteve nën ligjore që rregullojnë veprimtarinë farmaceutike; 1.3.2. Në QMF / AMF funksionojnë barnatoret doracake të cilat menaxhohen, furnizohen dhe monitorohen nga barnatorja Qendrore në QKMF; 1.3.3.Nga barnatorja qendrore dhe njesite e saja ne QMF/AMF shpërndahen vetëm barnat nga Lista Esenciale e Barnave, e lejuar nga Ministria dhe të përshkruara në recetat unike , nga Mjekët e Sektorit të Mjekësisë Familjare; 1.3.4.Me barnatoren qendore udhëheq Shefi i Barnatores. 2.Lista e Qendrave të Mjekësisë Familjare – QMF dhe Ambulancave të Mjekësisë Familjare-AMF në kuadër të QKMF-Istog përbën Rrjetin e institucioneve të KPSH në Komunën e Istogut. 3.Rrjeti i Institucioneve shëndetësore sipas paragrafit 5 do të jetë objekt i revidimit periodik që do të ndërmerret nga KK i Istogut me pëlqim të Ministrisë së Shëndetësisë.	1.1.6.2 Radiology Cabinet; 1.1.6.3.Laboratory. 1.2.The Administration Department of the MFMC (the name of respective municipality) consists of: 1.2.1. Human Resources Unit or Office; 1.2.2. Legal Unit or Office; 1.2.3. Budget and Finance Unit or Office; 1.2.4. Procurement Unit or Office; 1.2.5. Technical Services Unit or Office. 1.3.Central Pharmacy: 1.3.1.The central pharmacy is an organizational unit of MFMC which is established and operates according to the laws and sub-legal acts that regulate the pharmaceutical activity; 1.3.2. Within FMC /FMA operate manual pharmacies which are managed, supplied and monitored by the central pharmacy in MFMC; 1.3.3.The central pharmacy and its units in FMC /FMA distribute only the drugs from the Essential List of Medicines, allowed by the Ministry, and prescribed in unique prescriptions, by the Doctors of the Family Medicine Sector;	1.3. Centralna apoteka: 1.3.1.Centralna apoteka je organizaciona jedinica GCPM-a koja se osniva i funkcioniše prema zakonima i podzakonskim aktima koji uređuju farmaceutsku delatnost; 1.3.2. U CPM-u / AMF-u rade priručne apoteke koje se rukovode, snabdevaju i nadgledaju od centralne apoteke u GCPM-u; 1.3.3.Iz centralne apoteke i njenih jedinica pri CPM-u/APM-u mogu da se raspodele samo lekovi sa Esencijalne liste lekova, dozvoljene od Ministarstva, i propisanih u jedinstvenim receptima, od lekara Sektora porodične medicine; 1.3.4.Centralnu apoteku vodi šef apoteke. 2.Lista Centara porodične medicine–CPM-a i Ambulanti porodične medicine -APM u okviru GCPM-a (ime dotične opštine) sačinjava mrežu institucija PZN u opštini Istok. 3.Mreža zdravstvenih ustanova prema stavu 5. će biti predmet periodičnog revidiranja koje će se preduzeti od SO Istok uz saglasnost Ministarstva zdravstva.
--	---	--

Neni 10 Sistemi i Informimit Shëndetësor në QKMF 1.QKMF në Istog zbaton sistemin unik të informimit shëndetësor, ashtu siç është paraparë me Ligjin e Shëndetësisë dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë lëmi. 2.Departamenti i SISh në Ministrinë e Shëndetësisë në koordinim me QKMF bënë implementimin e Sistemit dhe funksionalizimin e tij në të gjitha nivelet e institucioneve të KPSH-së. 3.QKMF obligohet të përdor sistemin Informativ Shendetesor nga MSh për të gjitha llojet e shërbimeve të ofruara duke përfshirë edhe bashkëpagesat. 4.Në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale çdo profesionist shëndetësor obligohet që të ruaj konfidencialitetin e të dhënave për të gjitha veprimet e ndërmarra me Sistemin e Informimit Shëndetësor. V-Udhëheqja dhe trupat e QKMF Neni 11 Këshilli Drejtues, Struktura 1.Këshilli Drejtues ka 7 anëtarë:	1.3.4.The central pharmacy is managed by the Chief Pharmacist. 2.The list of Family Medicine Centers - FMC and Family Medicine Ambulances - FMA within the MFMC (the name of the respective municipality...) constitutes the Network of PHC institutions in the Municipality of (the name of the respective municipality...). 3.The network of health institutions according to paragraph 5 will be subject to periodic review which shall be undertaken by the MA (the name of the respective municipality ...) upon the consent by the Ministry of Health. Article 10 Health Information System in the MFMC 1.MFMC in (the name of the respective municipality ...) implements the unique health information system, as provided by the Law on Health and sub-legal acts regulating this field. 2.The HIS Department in the Ministry of Health in coordination with the MFMC carries out the implementation of the System and its functioning at all levels of PHC institutions.	Član 10 Sistem zdravstvenog informisanja u GCPM-u 1.GCPM u Istoku primenjuje jedinstveni sistem zdravstvenog informisanja, kao što je predviđeno Zakonom o Zdravstvu i podzakonskim aktima koji uređuju ovu oblast. 2.Departman ISZ-a pri Ministarstvu Zdravlja u koordinaciji sa GCPM-om vrši implementaciju sistema i njegovu funkcionalizaciju na svim nivoima ustanova IZS-a. 3.GCPM se obavezuje da koristi Informativni zdravstveni sistem od MZ-a sa sve vrste pruženih usluga uključujući i doplate. 4.Primenom zakona za zaštitu ličnih podataka, svaki zdravstveni stručnjak je dužan da čuva poverljivost podataka za sve preduzete radnje u Informativnom zdravstvenom sistemu. V-Upravljanje i tela GCPM-a Član 11 Upravni savet, struktura 1.Upravni savet ima 7 članova:
---	--	--

1.1.Drejtori i QKMF, i cili e kryeson Këshillin; 1.2.Udhëheqësi i Departamentit të Mjekësisë Familjare; 1.3.Kryeinfermieri/ja i/e QKMF; 1.4.Udhëheqësi i Departamentit të Administratës; 1.5.Koordinatori për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore; 1.6.Përfaqësuesi i sindikatës në cilësinë e vëzhguesit; 1.7.Përfaqësues nga Këshilli i pacientëve (pa drejtë vote). 2.Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues është i percaktuar sipas Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtar Publik. Mandati mund të përfundojë edhe më parë në rastet kur: 2.1.Anëtari ndërpre në marrëdhënien e punës në QKMF; 2.2.Anëtari i Këshillit Drejtues jep dorëheqje; 2.3.Anëtari i Këshillit Drejtues mungon pa arsye në mbledhje të Këshillit, brenda vitit, tri herë radhazi; 2.4.Anëtari nuk respekton detyrat e punës.	3.MFMC is obliged to use the Health Information System by the MoH for all types of provided services, including co-payments. 4.Pursuant to the law on the protection of personal data, every health professional is obliged to maintain the confidentiality of data for all actions taken within the Health Information System. V-MFMC administration and bodies Article 11 Board of Directors, Structure 1.The Board of Directors consists of 7 members: 1.1. Director of MFMC, who chairs the Board; 1.2.Head of Family Medicine Department; 1.3.MFMC Head Nurse; 1.4.Head of Administration Department; 1.5.Coordinator for improving the quality of health services; 1.6.Trade Union representative in the capacity of the observer; 1.7.Representatives from the Patient Council.	1.1.Direktor GCPM-a, koji upravlja Savetom; 1.2.Rukovodilac Odeljenja porodične medicine; 1.3.Glavna medicinska sestra GCPM-a; 1.4.Rukovodilac Odeljenja administracije; 1.5.Koordinator za povećanje kvaliteta zdravstvenih usluga; 1.6.Predstavnik Sindikata u svojstvu posmatrača (bez prava glasa); 1.7.Zastupljenost saveta pacijenata (bez prava glasa). 2.Mandat članova Upravnog saveta je određen na osnovu Zakona br. 08/L-197 za Javne Službenike. Mandat članova se može završi i ranije u slučajevima kada: 2.1. Član prekida radni odnos pri GCPM-om; 2.2. Član Upravnog saveta daje ostavku; 2.3.Član Upravnog saveta bez razloga odsustvuje na sastancima Saveta, unutar jedne godine, tri puta uzastopno; 2.4.Član ne poštuje radne zadatke.
---	---	---

Pabarazitë gjinore në gjendjen ekonomike: Në Komunën e Istogut ashtu si në tërë vendin, gjendja e vështirë ekonomike rëndon më shumë mbi femrat, të cilat kanë numrin më të madh të të papunësuarve dhe nivelin më të ulët arsimor. Në vitin 2021, numri i përgjithshëm i të punësuarve në Institucionet Komunale është 195 të shërbimit civil, nga kjo shifër vetëm femra janë 64 , duke përfshi edhe komunitete jo shumicë që kanë shifrën 12 të punësuar, nga kjo shifër janë 8 femra dhe 4 meshkuj. Kjo shifër tregon se gjendja ekonomiko sociale nuk është në nivel të kënaqshëm.

Probleme sociale të lidhura me dhunën në familje: Martesat e hershme janë një ndër dukuritë evidente në komunën e Istogut që prek vajzat dhe djemtë, ndonëse vajzat janë në numër më të madh dhe përballen me pasoja më të shumta. Martesat e hershme privojnë të rinjtë, e sidomos vajzat nga arsimimi dhe zhvillimi i perspektivave afatgjata. Vajzat lindin fëmijë në moshën e tyre më të hershme, mbeten të izoluar nga shoqet, shokët dhe familja e tyre. Gratë e reja nuk mund të dalin vetëm, pa pajtimin e burrit apo anëtarëve tjerë të familjes dhe nuk fitojnë të ardhura, po ashtu si shkakton ekonomik është edhe ndarja jo e barabartë nga trashëgimia familjare pikërisht kemi cenim ndaj të drejtave të njeriut dhe diskriminim gjinore duke i trashëguar paragjykimet dhe stereotipet , ndaj mbeten të varura ekonomikisht dhe nuk janë vendimmarrëse në ekonominë familjare. Për këto arsye, këto gra të reja janë më të prekura nga dhuna në familje. Sipas disa të dhënave, numri i rasteve të paraqitura në Qendrën për Punë Sociale (QPS) – Istogut për dhënien e pëlqimit për martesë të hershme ndryshon:

viti 2021: Numri i rasteve - 2

viti 2022: Nuk ka pasur raste

viti 2023: Numri i rasteve - 1

Numri i rasteve është dukshëm më i madh, por për shumë prej tyre nuk ka raportime.

Dhuna në Familje sjell shumë pasoja në komunitet, të cilat kanë një numër të madh efektesh të padëshiruara:

Kriza familjare: Avancimi i rolit të femrës në shoqëri dhe pozita e saj në familje ka ndryshuar në kuptimin e pavarësisht më të madh të saj, marrjes së iniciativave, edukimit dhe arsimimit, fakte të cilat kanë ndikuar në ndryshimin e roleve në familje dhe shoqëri. Kriza familjare në periudhën e pas luftës në Kosovë ka shkaqe të ndryshme: lëvizja e popullatës nga fshatrat në qytete, kalimi nga familjet e zgjeruara dhe të mëdha në familje më të vogla. Të tilla ndryshime shihen si faktorë mbrojtës (kur shmanget ndikimi patriarkal prej brezave më të vjetër), por edhe faktorë rreziku njëherësh, si pamundësia e mbrojtjes në rastet e dhunës në familje të nxitura nga papunësia, konfliktet dhe mentalitetit mes gjeneratave, etj.

RRITJA E DIVORCEVE NË SHOQËRI: Numri i divorceve ndryshon nga viti në vit. Në vitin 2021 ka pasur 24 kërkesa për divorc, në vitin 2022 kanë qenë 38 kërkesa, ndërsa në vitin 2023 janë 22 kërkesa. Sa i përket rritjes së numrit të divorceve nga viti në vit, nuk kemi arritur të nxjerrim ndonjë përfundim, këto statistika janë nga Qendra për Punë Sociale.

Nga tregues statistikor, numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara në Shtëpinë e Sigurtë edhe pse kjo Shtëpi e Sigurtë mbulon Regjionin e Istogut për vitin 2021 janë strehuar gjithsej 8 gra dhe 5 fëmijë, prej tyre 6 gra dhe 3 fëmijë nga komuniteti shqiptar, 1 grua dhe 2 fëmijë nga komuniteti rom si dhe 1 grua nga komuniteti boshnjak. Ndërsa në vitin 2022 janë strehuar 3 gra dhe 2 fëmijë gjithsej, prej tyre 1 grua nga komuniteti shqiptar, 1 nga komuniteti boshnjak, 1 grua nga komuniteti rom. Në vitin 2023 janë strehuar gjithsej 11 gra dhe 8 fëmijë, prej tyre 6 gra nga komuniteti shqiptar, 3 komuniteti rom dhe 2 nga komuniteti boshnjak ndaj të cilave është ushtruar dhunë në familje, qëndrimi i këtyre viktimave nuk është e definuar në mënyrë të saktë, sepse ndodhin raste që të qëndrojnë edhe me tepër se 6 muaj deri në Vendimet Gjyqësore.

Në bazë të statistikave nga Policia e Kosovës raportohet se në vitin 2021 kemi pas 73 raste të dhunës në familje, prej tyre 63 janë viktima femra dhe 13 viktima meshkuj, nga të cilët 56 nga komuniteti Shqiptar , 5 Ashkali dhe 15 Egjiptian, ndërsa duke ju referuar moshës i përfshin:

16-20 vjeç janë 7 raste
20-30 vjeç janë 13 raste
30-40 vjeç janë 30 raste
40-50 vjeç janë 16 raste
50-60 vjeç janë 6 raste
60-70 vjeç janë 3 raste
70-80 vjeç janë 2 raste

Ndërsa në vitin 2022 raportohet se kemi pasur 47 viktima të dhunës në familje prej tyre 41 femra dhe 6 meshkuj, nga të cilët 37 nga komuniteti shqiptarë, 1 boshnjak, 2 rom dhe 6 egjiptian, ndërsa duke ju referuar moshës i përfshin:

0-18 janë 3 raste
18-20 janë 2 raste
20-30 janë 18 raste
30-40 janë 8 raste
40-50 janë 7 raste
50-60 është 2 raste
70-80 është 1 rast

Ndërsa në vitin 2023 raportohet se kemi pasur 67 viktima të dhunës në familje prej tyre 49 femra dhe 18 meshkuj, nga të cilët 49 nga komuniteti shqiptarë , 4 boshnjak, 1 rom, 3 ashkali dhe 9 egjiptian, ndërsa duke ju referuar moshës i përfshin:

0-18 janë 15 raste
18-20 janë 2 raste
20-30 janë 13 raste
30-40 janë 21 raste
40-50 janë 8 raste
50-60 janë 4 raste
60-70 janë 3 raste
70-80 janë 2 raste

Pasi që qëndrimi në strehimoren “Shtëpia e Sigurtë” është i përkohshëm, deri në 6 muaj, por në strehimore ndodh që për ndonjë rast më specifik strehimi ti vazhdohet deri në 1 vit, por varësisht nga rasti ndodh që edhe deri në dy vite. Viktimat e dhunës në familje, pas qëndrimit gjatëmuor transferohen në strehimoret tjera (në regjionet tjera të Republikës së Kosovës), ku në çdo strehimore qëndrimi i tyre zgjat jo më tepër se gjashtë muaj. Mandej këto viktimat të dhunës, nuk kanë zgjidhje tjetër, ose të kthehen në shtëpinë e gjinisë së tyre, ku shpeshherë ndodhë që mos ti pranojnë edhe ato, ose të kthehen sërish tek kryerësi i cili ka ushtruar dhunë ndaj tyre, pasi që nuk mund të bëjnë zgjidhje tjetër.

Krahas numrit të raportuar, rastet e dhunës në familje mbeten më tepër raste të izoluara dhe shumë pak të raportuara. Nga ndryshimet e statistikave nga viti në vit, vërehet se ka një rritje të raportimit të rasteve të dhunës në familje në institucionet gjegjëse, që na bënë të kuptojmë se është rritur dukshëm vetëdijesimi qytetar për të raportuar dhunën krahasuar me periudhat e mëhershme, por njëkohësisht është rritur edhe besimi qytetar në institucionet që luftojnë këtë fenomen.

Viktima të dhunës në familje, marrë për bazë statistikën e vitit 2021, 2022 dhe 2023, kryesisht janë nga gjinia femërore.

Frika dhe ndërgjegjësimi ulët për çështjet e dhunës në familje: Mos raportimi i dhunës në familje nga viktimat është ndër fenomenet më të shpeshta, pasi konsiderohet turp dhe një çështje që nuk duhet të dalë jashtë mureve të shtëpisë.

Mospranimi i dhunës seksuale: Për shkak të stigmës dhe ndëshkimit vërehet mos raportim i dhunës nga ana e viktimave dhe për këtë dhuna seksuale rezulton më pak e raportuar ose nuk ekziston fare në krahasim me dhunën fizike.

Probleme lidhur me trashëgiminë: Sa i përket procedurave të shqyrtimit të trashëgimisë, shumë herë ndodh që gruaja nuk njoftohet fare ose përjashtohet nga diskutimi për masën trashëgimore, qoftë në pozitën e bashkëshortes, nënës apo motrës dhe në këtë mënyrë diskriminohet. Veç kësaj, organi kompetent komunal për mbajtjen e librit amzë të vdekjeve ka për detyrë që në aktvdekje të shënojë emrat e trashëgimtarëve femra dhe meshkuj dhe assesi të mos i diskriminojë femrat.

KAPITULLI 4:

KOHËZGJATJA E ZBATIMIT TË STRATEGJISË DHE INSTITUCIONET E PËRFSHIRA

Shtrirja kohore e strategjisë

Strategjia Komunale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është paraparë si një strategji 4 vjeçare që do të zbatohet në periudhën 2024-2027.

Institucionet zbatuese dhe partnere

Komuna Istogut është institucioni kryesor zbatues i strategjisë me drejtoritë përkatëse si dhe Mekanizimin Koordinues kundër Dhunës në Familje që do të kontribuon në promovimin e ligjeve për mbrojtje nga dhuna në familje, si dhe atë të trashëgimisë dhe familjes, informim që ndikon në parandalimin e këtij fenomeni. Këto organe kanë për detyrë që të promovojnë mundësi të barabarta për të gjithë, pa marrë parasysh

përkatësinë gjinore, fetare, etnike, moshë e racë, t'i promovojë vlerat për të drejtat e njeriut, si dhe të kujdeset për zbatimin e standardeve dhe raportimin mbi realizimin e tyre.

Ndër institucionet e tjera të përfshira në zbatimin e elementeve të caktuara të kësaj strategjie janë:

Policia e Kosovës, Komiteti Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB , Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, OJQ-të.

Zyra për Punësim: Në koordinim me Qendrën për Punë Sociale, regjistron dhe evidenton personat, të cilët lajmërohen në zyrë, ndaj të cilëve është ushtruar dhunë në familje. Këtyre personave në cilësi të punëkërkuesve, ju ofrohet: këshillim profesional, informim mbi mundësitë e punësimit, përgatitje dhe ndërmjetësim në punësim, informim për aftësim dhe riaftësim profesional me qëllim përgatitjen për nevojat e tregut të punës.

Mbrojtësi i viktimave i cili bashkëpunon ngushtë me institucionet e tjera që ofrojnë ndihmë për viktimat e Dhunës në Familje, dhe lloje të tjera të dhunës apo trafikimit me qenie njerëzore etj, si Policinë, QPS, Prokurorinë, Gjykatën, QKMF, Spitalin, Strehimoren, etj. Ndër detyrat e tij është të informojë viktimën për të drejtat ligjore, të parapara sipas ligjeve në fuqi për dhunën në familje, të parapërgatitë viktimën për seancat gjyqësore, e shoqëron gjatë seancave si në Prokurori dhe Gjykatë, etj.

KAPITULLI 5:

AKTIVITETET NË ZBATIM TË STRATEGJISË

(Plani i Veprimit të kësaj Strategjie gjendet i bashkëlidhur në Shtojcën 1)

Arritja e objektivave strategjike të kësaj Strategjie është paraparë të kryhet përmes zbërthimit të tyre në disa objektiva specifike me aktivitetet përkatëse.

Aktivitetet në Planin e Veprimit janë renditur sipas tri shtyllave bazë të përcaktuara edhe në Planin e Veprimit të Kosovës: **Parandalim, Mbrojtje dhe Riintegrim**. Për arritjen e objektivave të kësaj Strategjie, aktivitetet janë specifikuar edhe sipas prioritetit për zbatim:

Afat Shkurtra: aktivitete të rëndësisë së lartë që duhet të zbatohen brenda një afati kohor të shkurtër 6 muaj – 1 vit. Të tilla mund të jenë ngritja dhe forcimi institucional për adresimin e Dhunës në Familje, çështje që lidhen me forcimin e mbrojtjes etj.

Afat Mesme: aktivitete të rëndësishme që duhet zbatohen brenda periudhës kohore 1-2 vjeçare. Ndër aktivitete të tilla mund të jenë edhe ato që kërkojnë fonde, të cilat duhet të sigurohen nga institucionet gjegjëse për implementimin e kësaj strategjie.

Afat Gjata: janë renditur të gjitha aktivitetet të cilat synojnë konsolidimin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të mbështetjes që u jepet të mbijetuarave prej Dhunës në Familje, shërbimeve cilësore, etj.

Aktivite në vijimësi: janë aktivitete, të cilat do të kryhen prej institucioneve zbatuese dhe atyre partnere në vijimësi, si pjesë e punës së tyre. Ndër to mund të përmendim aktivitetet që kanë të bëjnë me parandalimin, informimin dhe vetëdijesimin e komunitetit.

Objektivat specifike dhe disa prej aktiviteteve të planifikuara në Planin e Veprimit renditen si më poshtë:

FUSHA E VEPRIMIT –

A. ELIMINIMI I PABARAZIVE GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE

Objektiv Specifik A.1.

Eliminimi i stereotipeve gjinore për luftimin e dhunës në familje:

Aktivitete:

- Fushata vetëdijësuese dhe kampanja informuese mediatike për publikun e gjerë në komunën e Istogut
- Trajnimet për barazi gjinore dhe dhunën në familje me përfaqësues të institucioneve komunale

Objektiv Specifik A.2.

Ngritja e vetëdijesimit të grave dhe të rinjve, institucioneve dhe OJQ-ve për pasojat e dhunës në familje dhe të pabarazive gjinore.

Aktivitete:

- Fushata (drama me temë të barazisë gjinore dhe dhunës në familje , ligjërata, ese, dhe piktura me të rinjtë dhe grupe të ndryshme të interesit)
- Takime me gra dhe vajza në fshatra për të drejtat e tyre ligjore, me fokus në Dhunën në Familje. Gjatë takimeve do të shpërndahen informacione dhe fletëpalosje
- Debate të hapura dhe emisione televizive me tematika rreth Dhunës në Familje, me përfaqësues të institucioneve dhe të OJQ-ve

Objektiv Specifik A.3.

Fuqizimi i rolit të gruas në shoqëri përmes promovimit dhe rritjes së numrit të femrave në pozicionet vendimmarrëse

Aktivitete:

- Ndarja e përvojave të suksesshme të grave në pozita udhëheqëse gjatë takimeve me gratë dhe komunitetin

FUSHA E VEPRIMIT – B. ARSIMIMI DHE INFORMIMI

Objektiv Specifik B.1:

Ndërgjegjësimi i nxënësve dhe prindërve të Arsimit të Mesëm të Ulët dhe Arsimit të Mesëm të Lartë për çështjet e Dhunës në Familje dhe LMDHF

Aktivitete:

- Aktivitete informuese nëpërmjet mekanizmit koordinues, në kuadër të orëve mësimore dhe të fletëpalosjeve, broshurave, etj
- Informimi i prindërve për mekanizmin koordinues nëpërmjet zyrtarëve të arsimit
- Aktivitete informuese dhe edukuese në kuadër të programit të aktiviteteve shkollore me pjesëmarrjen e nxënësve (orë mësimore, fushata, fletëpalosje)

Objektiv Specifik B.2:

Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve të Edukatës Qytetare lidhur me Dhunën në Familje dhe trajtimin e saj

Aktivitete:

- Organizimi i trajnimeve të mësimdhënësve të Edukatës Qytetare për çështje të Dhunës në Familje
- Organizimi i shkëmbimit të përvojave përmes vizitave studimore të specialistëve të kësaj fushe

Objektiv Specifik B.3:

Ulja e numrit të nxënësve që braktisin shkollën e mesme të ulët dhe të lartë si rezultat i Dhunës në Familje, në zonat rurale apo komunitete të ndryshme

Aktivitete:

- Kryerja e hulumtimeve sociologjike mbi shkaqet kryesore të braktisjes së shkollës prej nxënësve
- Vetëdijësimi nëpërmjet liderëve të komuniteteve dhe ndërmjetësuesve përmes takimeve dhe punës me familje të veçanta që shfaqin probleme të Dhunës në Familje
- Aplikimi i masave ligjore që sanksionojnë braktisjen e shkollës

FUSHA E VEPRIMIT – C: FUQIZIMI I BAZËS EKONOMIKE

Objektiv Specifik C.1:

Fuqizimi ekonomik i viktimave të dhunës në familje në përkrahjen për punësim dhe vetëpunësim

Aktivitete:

- Regjistrimi, evidentimi dhe orientimi i viktimave të Dhunës në Familje
- Ofrimi i këshillave në prezantimin e dokumentacionit për aplikim të suksesshëm sipas tregut të punës
- Hartimi i kuadrit nënligjor, përmes nxjerrjes së një vendimi në nivel komunal, për lirimin nga taksat komunale për rastet e dhunës në familje në rastet e hapjes së një biznesi të ri

Objektiv Specifik C.2:

Mbështetje socio-ekonomike të mbijetuarve të Dhunës në Familje

Aktivitete:

- Ofrimi i trajnimeve për ngritjen profesionale, informacioneve për mundësitë për biznes
- Ofrimin e mbështetjes ekonomike me fond të veçantë prej komunës
- Ndarja e subvencioneve për familjet në zonën rurale përmes ndarjes së subvencioneve për bujqësi si dhe hapja e bizneseve të vogla
- Përkrahja e Strehimore, rritja e kapacitetit për shkak të numrit të strehuarve jo i mjaftueshëm për kryerjen e shërbimeve dhe mbështetjen e të mbijetuarve të dhunës në familje si dhe bashkëpunimi me mekanizmat që merren me çështjet e dhunës në familje

Objektiv Specifik C.3:

Zgjidhje e strehimit për rastet e të mbijetuarve të Dhunës në Familje

Aktivitete:

- Ofrimin e mbështetjes ekonomike përmes pagesës së qirasë për rastet e pazgjidhura

FUSHA E VEPRIMIT –

D: FUQIZIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Objektiv Specifik D.1:

Fuqizimi i Mekanizmit koordinues në nivel të komunës

Aktivitete:

- Takime me strukturat udhëheqëse të komunës për qartësimin e roleve dhe përgjegjësi
- Takime periodike të Mekanizmit Koordinues kundër Dhunës në Familje për shkëmbim informacioni dhe koordinim aktivitetesh

Objektiv Specifik D.2:

Rritja e vetëdijes për identifikimin sa më të hershëm të situatave të rrezikut për Dhunën në Familje prej secilit institucion dhe planifikimin e masave parandaluese

Aktivitete:

- Identifikimi i rasteve të dhunës në familje
- Regjistrimi në data bazë dhe vlerësimi i nevojave të mbijetuarve të dhunës në familje

KAPITULLI 6

PLANI I MONITORIMIT DHE I VLERËSIMIT TË PROGRESIT NË ZBATIM

Për monitorimin dhe zbatimin e kësaj strategjie obligohet Komuna e Istogut dhe drejtoritë përkatëse në këtë dokument.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të saj si dhe ato partnere duhet të informojnë në mënyrë të rregullt Zyrën e Kryetarit - me anë të të dhënave mbi arritjen e objektivave dhe realizimin e aktiviteteve të përcaktuara.

Të paktën një herë në vit, Kryetari i Komunës raporton në Kuvendin e Komunës mbi progresin në zbatimin e strategjisë sipas treguesve të përcaktuar për çdo drejtim strategjik.

SHTOJCA 1:

PLANI I VEPRIMIT

Komuna Istogut

PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2026)

FUSHA E VEPRIMIT – A. ELIMINIMI I PABARAZIVE GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE Deri në vitin 2026, strategjia lokale synon të ndryshoj qasjen në familje dhe shoqëri për eliminimin e pabarazisë gjinore dhe dhunën në familje				
Objektivat specifike	Aktivitete	Koha e zbatimit Sipas shtyllave: <u>P</u>arandalim, <u>M</u>brojtje, <u>R</u>iintegrim Sipas kohës së zbatimit: ASH – Afatshkurtër, AM – Afatmesëm; AGJ –Afatgjatë Aktivitet në vijëmesi,	Indikatori i suksesit	Institucionet përgjegjëse për zbatim
A.1. Eliminimi i stereotipeve gjinore për luftimin e dhunës në familje	1.1 Fushata vetëdijësuese dhe kampanja informuese mediatike për publikun e gjere në komunën e Istogut	P+M+R ASH+AM	Prej rreth 39.200 banorëve , rreth 30% e tyre kanë marr mesazhin dhe janë bërë pjesë e aktiviteteve ndërgjegjësuese	Institucioni Përgjegjës: Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete, QPS Institucione Partnere: Komuna OJQ-te Media lokale
	1.2 Trajnimet për Barazi gjinore dhe dhunën në familje me përfaqësues të institucioneve vendore	P+M+R ASH		
A.2. Ngritja e vetëdijesimit të grave dhe të rinjve , institucioneve dhe bizneseve për pasojat e dhunës në familje dhe të pabarazisë gjinore	2.1 Fushata (drama, me temë të barazisë gjinore dhe dhunës në familje , ligjërata, ese, dhe piktura) me të rinjtë	P Aktivitet në vijimësi	Rritja e përqindjes së grave dhe vajzave të ndërgjegjësuar nga 30% në 45%	Institucioni Përgjegjës: OJQ-te Institucione Partnere: Komuna Bizneset Donatorë

A.3. Fuqizimi i rolit të gruas në shoqëri përmes promovimit dhe rritjes së numrit të femrave në pozitë vendimmarrëse	3.1 Ndarja e përvojave të suksesshme të grave në pozita udhëheqëse gjatë takimeve me gratë dhe komunitetin	Aktivitet në vijimësi	Rritja e numrit të grave në pozita udhëheqëse deri në 50%	Institucioni Përgjegjës: Komuna Kryetari i Komunës Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete

FUSHA E VEPRIMIT – B. ARSIMIMI DHE INFORMIMI

Deri në vitin 2026, strategjia lokale synon një komunitet të mirë informuar , edukuar në çështjet e dhunës në familje , me profesionistë të aftë dhe të përgatitur për të parandaluar, njohur dhe kualifikuar për trajtimin adekuat të viktimave të dhunës në familje dhe të komunitetit në tërësi

Objektivat specifike	Aktivitete	Lidhja me Strategjinë Kombëtare dhe Koha e zbatimit sipas shtyllave: <u>P</u>arandalim, <u>M</u>brojtje, <u>R</u>iintegrim Sipas kohës së zbatimit: ASH – Afatshkurtër, AM – Afatmesëm; AGJ –Afatgjatë Aktivitet në vijimësi	Indikatori i suksesit	Institucionet përgjegjëse për zbatim
B.1 Ndërgjegjësimi i nxënësve dhe prindërve të AMU dhe AML për çështjet e DHF dhe LMDF	1.1 Aktivitete informuese nëpërmjet mekanizmit koordinues, në kuadër të orëve mësimore dhe të fletëpalosjeve, broshurave, etj	P+M+R Aktivitet në vijimësi	Deri në vitin 2026, rreth 50% e nxënësve dhe prindërve janë të ndërgjegjësuar për LMDF dhe DHF	Institucioni Përgjegjës: Mekanizmi Koordinues Kundër Dhunës në Familje

	1.2 Informimi i prindërve për mekanizmin koordinues nëpërmjet zyrtareve të arsimit	P Aktivitet në vijimësi		Institucione Partner: Drejtoria e Arsimit, OJQ-të
	1.3 Aktivitete informuese dhe edukuese në kuadër të programit të aktiviteteve shkollore me pjesëmarrjen e nxënësve (orë mësimore, fushata, postera)	P ASH + AM		
B.2 Ngritja profesionale e mësimdhënësve të Edukatës Qytetare lidhur me DHF dhe trajtimin e saj	2.1 Organizimi i trajnimeve të mësimdhënësve të Edukatës Qytetare për çështje të DHF	P Aktivitet në vijimësi	Deri në vitin 2026, 30% e orëve të Edukatës Qytetare do të kalojnë në tematika të DHF	Institucioni Përgjegjës: Drejtoria e Arsimit Institucione Partner: OJQ
	2.2 Ngritja e qendrave didaktike të integruara me programe të veçanta për trajnimin mbi çështje të DHF	P AM		
	2.3 Organizimi i vizitave studimore për shkëmbimin e përvojave me vendet e rajonit	P AM		
B.3 Ulja e numrit të nxënësve që braktisin shkollën e ulët dhe të lartë si rezultat i DHF, në zonat rurale apo komunitete të ndryshme	3.1 Kryerja e hulumtimeve sociologjike mbi shkaqet kryesore të braktisjes së shkollës prej nxënësve të familjeve ku ushtrohet dhunë	P+M+R ASH	Deri në vitin 2026, numri i nxënësve që braktisin shkollën prej DHF ulet nga <u>5%</u> në <u>3%</u>	Institucioni Përgjegjës: Drejtoria e Arsimit Institucione Partner: Mekanizmi Koordinues
	3.2 Vetëdijesimi nëpërmjet liderëve të komuniteteve dhe ndërmjetësuesve përmes takimeve dhe punës me	P+M+R ASH+AM		

	familje të veçanta që shfaqin probleme të DHF			Kundër Dhunës në Familje Qendra për Punë Sociale
	3.3 Monitorimi i aplikimit të masave ligjore që sanksionojnë braktisjen e shkollës	P+M ASH+AM		

FUSHA E VEPRIMIT – C. FUQIZIMI I BAZËS EKONOMIKE

Deri në vitin 2026, strategjia lokale synon në parandalimin, mbrojtjen dhe riintegrimin përmes mbështetjes ekonomike dhe dhënien e mundësive për mirëqenien e të mbijetuarave të DHF dhe të familjeve të tyre

Objektivat specifike	Aktivitete	Lidhja me Strategjinë Kombëtare dhe Koha e zbatimit sipas shtyllave: <u>P</u>arandalim, <u>M</u>brojtje, <u>R</u>i integrim Sipas kohës së zbatimit: ASH – Afatshkurtër, AM – Afatmesëm; AGJ – Afatgjatë Aktivitete në vijimësi	Indikatori i suksesit	Institucionet përgjegjëse për zbatim
C.1 Fuqizimi ekonomik i viktimave të dhunës në familje në përkrahjen për punësim dhe vetëpunësim	1.1 Regjistrimi, evidentimi dhe orientimi i viktimave të DHF pranë komunës	M+R AM	Brenda 3 viteve sistemi i regjistrimit dhe orientimit behët funksional sipas	Institucioni Përgjegjës: Komuna

	1.2 Ofrimi i këshillave në prezantimin e dokumentacionit për aplikim të suksesshëm sipas tregut të punës	M+R Aktivitet në vijimësi	standardeve kombëtare në përpunim	Institucione Partner: Qendra për Punë Sociale Zyra e Punësimit Donatorë Sipas përcaktimit të standardit kombëtar
	1.3 Hartimi i kuadrit nënligjor, përmes nxjerrjes së një vendimi në nivel komunal, për lirim nga taksat komunale në rastet e hapjes së një biznesi të ri	M+R ASH		
C.2. Mbështetje socio ekonomike të mbijetuarave të DHF	2.1 Ofrimi i trajnimeve për ngritjen profesionale, informacioneve për mundësitë për biznes	M+R Aktivitet në vijimësi	50% e grave përfitojnë nga shërbimet në këtë kategori	Institucioni Përgjegjës: Komuna Drejtoria për Mirëqenie Sociale Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete Institucione Partnere: OJQ - të Donatorët,
	2.2 Ofrimin e mbështetjes ekonomike me fond të veçantë prej komunës	M+R AM		
	2.3 Ndarja e subvencioneve për familjet në zonën rurale përmes ndarjes së subvencioneve dhe përkrahja e bizneseve të vogla	P+M+R AM		
	2.4 Përkrahje e strehimores “Shtëpia e Sigurtë” për kryerjen e shërbimeve dhe mbështetjen e të mbijetuarave të DHF	M+R Aktivitet në vijimësi		

C.3. Zgjidhje afatmesme e strehimit për rastet e të mbijetuarave të DHF	3.1 Pagesa e qirasë për vendstrehimin e viktimave të dhunës në familje	M+R Aktivitet në vijimësi		Institucioni Përgjegjës: Komuna
	3.2 Ofrimin e mbështetjes ekonomike përmes pagesës së qirasë për rastet e pazgjedhura	M+R AM		Institucione Partner: Donatorë

FUSHA E VEPRIMIT – D. FUQIZIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Deri në vitin 2026, strategjia lokale synon të ketë institucione funksionale dhe të mirë koordinuara për parandalimin, mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe riintegrimin e tyre dhe të familjeve në jetën ekonomike dhe sociale të komunës.

Objektivat specifike	Aktivitete	Lidhja me Strategjinë Kombëtare dhe Koha e zbatimit sipas shtyllave: <u>Parandalim</u> , <u>Mbrojtje</u> , <u>Riintegrim</u> Sipas kohës së zbatimit: ASH – Afatshkurtër, AM – Afatmesëm; AGJ – Afatgjatë Aktivitete në vijimësi	Indikatori i suksesit	Institucionet përgjegjëse për zbatim
D.1 Institucionalizimi i Mekanizmit Koordinues kundër Dhunës në Familje në nivel të komunës	1.1 Takime me strukturat udhëheqëse të komunës për qartësimin e roleve dhe përgjegjësi	P+M+R ASH	Të paktën 4 takime të organizuara çdo vit si dhe takime	Institucioni Përgjegjës: Mekanizmi Koordinues kundër Dhunës në Familje-Koordinatorja
	1.2 Takime periodike të Mekanizmit Koordinues kundër Dhunës në Familje për shkëmbim informacioni dhe koordinimin e veprimeve konkrete.	P+M+R Aktivitet në vijimësi		
D.2 Rritja e vetëdijes për identifikimin sa me të hershem të situatave të rrezikut për DHF prej secilit institucion dhe	2.1 Hartimi i formularëve të posaçëm për raportimin e rasteve të rrezikut për DHF dhe rasteve të identifikuara	P+M ASH	Deri në fund të vitit 2026 institucionet e komunës do të kenë të ngritur sistemin e identifikimit , regjistrimit dhe	Institucioni Përgjegjës: Mekanizmi Koordinues kundër

planifikimin e masave parandaluese	2.3 Identifikimi i shkaqeve që paraprijnë rastet e DHF përmes analizimit me anë të anketimeve në shkolla, institucione shëndetësore, diskutimeve mediatike me specialistë	P+M AGJ	vlerësimit të rasteve të DHF.	Dhunës në Familje Qendra për Punë Sociale Policia
			Të dhënat për shkaqet dhe situatën janë të mbledhura në bazë periodike	Institucione Partner: OJQ, shkolla
	2.4 Planifikim i punës dhe mbështetjes institucionale për grupet me të cënueshme për DHF (përfshirë pleqtë, të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara)	P+M+R AGJ	Numri i rasteve të ndihmuara/rehabilituara	

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
01 Nr.54/2024	Datë: 13.02.2024		

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 58 pika (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale publikuar në (Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008) dhe nenin 68, pika 8 e Statutit të Komunës 01 Nr. 62/10 të datës 30.11.2010 i :

Propozon

Kuvendit të Komunës, që në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d), nenit 14 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 11 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 06/L-092 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019), nenit 23 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010, nenit 53, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në shkresën e pranuar nga MAPL- ja. që në mbledhjen e mbajtur më 29.02.2024 të miratojë këtë:

VENDIM

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT 01.NR.209/2023 DT.28.12.2023 PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIIN E VENDIMIT 01.NR.13/2023 TË DATËS 18.02.2020 PËR DHËNIËN NË SHFRYTËZIM ME NEGOCIM TË PRONËS SE PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË ISTOGUT SI DHE "ULPIANA BALAJ" SHPK

1.I propozohet kuvendit komunal shfuqizimi i vendimit 01.Nr.209/23 i datës 28.12.2023 për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 01 Nr. 13/2020 të miratuar më 18.02.2020 nga Kuvendi i Komunës për dhënien në shfrytëzim me negociim për 30 vite, pronën e paluajtshme të komunës, Njësinë Kadastrale 136-9, Zona Kadastrale - Gurakoc me sipërfaqe prej 1935 m², investitori Xhevdet Balaj, pronar i "ULPIANA BALAJ" SHPK, me shumën e qirasë vjetore prej 840 (tetëqind e katër dhjetë) euro.

2.Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal MAPL ,pas shqyrtimit të ligjshmërisë të përmbajtjes së aktit të komunës vlerëson se akti i komunës nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

3.Pas miratimit të këtij propozim vendimi për shfuqizim nga ana e Kuvendit të Komunës së Istogut dhe dërgimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal -MAPL i njëjti hyn në fuqi ashtu siç është përcaktuar në nenin me nenin 81 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ,nenin 17 të Rregullores Nr.01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web faqen e Komunës.

4.Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen ,Zyra e Kryetarit ,Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi si dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis.

Udhëheqëse e Zyrës Ligjore

Zekije Sutaj




Kryetari i Komunës

Ilir FERATI






Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istok
Municipality Istog

KUVENDI I KOMUNËS/ SKUPŠTINA OPŠTINE/ MUNICIPAL ASSEMBLY

00 Nr.209/2023
Datë: 28.12.2023

Kuvendit të Komunës, që në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d), nenit 14 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 11 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 06/L-092 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019), nenit 23 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010, nenit 53, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të Kuvendit të Komunës 01 Nr. 13/2020 të datës 18.02.2020 lidhur me dhënien në shfrytëzim afatgjatë me negociim pronën e paluajtshme të komunës, Njësinë Kadastrale 136-9, Zona Kadastrale – Gurrakoc investitorit Xhevdet Balaj, pronar i “ Ulpiana Balaj ” SH.P.K. që në mbledhjen e mbajtur më 28.12.2023 të miratojë këtë:

VENDIM

PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E VENDIMIT 01 NR. 13/2020 TË DATËS 18.02.2020 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM ME NEGOCIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS “ULPIANA BALAJ” SHPK

1. **MIRATOHET** Vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 01 Nr. 13/2020 të miratuar më 18.02.2020 nga Kuvendi i Komunës për dhënien në shfrytëzim me negociim për 30 vite, pronën e paluajtshme të komunës, Njësinë Kadastrale 136-9, Zona Kadastrale – Gurrakoc me sipërfaqe prej 1935 m², investitori Xhevdet Balaj, pronar i “ULPIANA BALAJ” SHPK, me shumën e qirasë vjetore prej 840 € (tetëqind e katërdhjetë euro).
2. Sipas vendimit të cekur në pikën I, ndryshim-plotësimi nënkupton:
 - 2.1 Plotësohet vendimi 01 Nr. 13/2020 i datës 18.02.2020 sipas së cilit bëhet zgjerimi i ofrimit të shërbimeve dhe shitjes së produkteve të ndryshme me pakicë në Njësinë Kadastrale 136-9, Zona Kadastrale – Gurrakoc, me qëllim të sigurimit për zgjerimin e vendeve të reja të punës dhe shitjen e produkteve prodhuese nga veprimtaria shtesë e biznesit përmes hapjes së pikës për shitje.

3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë me negocim të pronës së paluajtshme të Komunës është zhvillimi i aktiviteteve aktuale të këtij biznesi, rritja e vlerës së pronës së komunës, rritja e investimeve si dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtoria për Inspektion dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqe të Komunës

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim Vendimi është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010.

Sipas vendimit të Kuvendit të Komunës 01 Nr. 13/2020 të datës 18.02.2020 investitorit Xhevdet Balaj, pronar i " Ulpiana Balaj " SH.P.K. iu kishte dhënë në shfrytëzim afatgjatë me negocim për 30 vite prona e paluajtshme të komunës, Njësia Kadastrale 136-9, Zona Kadastrale – Gurakoc ku sipas projektit ideor të investitorit qëllimi ishte: grumbullimi i pemëve farore: molla, dardha, kumbulla etj, grumbullimi i pemëve manore: mjedër, boronicë, dredhëz, manaferrë, drithëra dhe perime. Përpunimi i lëngjeve, reçelrave, marmelatave, drithërave, konservim i misrit dhe përpunimi i frutave të malit.

Investitorit iu ka pamundësuar realizimi i investimit në mënyrë të plotë sipas planit ideor të paraparë me rastin e marrjes së pronës së komunës në shfrytëzim me negocim për shkak të paraqitjes së pandemisë Covid-19 e cila ka ndikuar në qëndrueshmërinë e realizimit të projektit andaj bazuar në këtë më 07.12.2023 investitori përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar kërkesën Nr. 01-016-49695 në të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet zgjerimi i ofrimit të shërbimeve përmes shitjes së produkteve të ndryshme me pakicë në po të njëjtën pronë të cilën e ka marr në shfrytëzim me negocim për të siguruar zgjerimin e vendeve të reja të punës dhe shitje të sigurt të produkteve që do të prodhohen nga veprimtaria shtesë biznesore duke i mundësuar shitjen e produkteve prodhuese përmes hapjes së pikës së shitjes.

Kryetari i Komunës duke u bazuar në nenin 11 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, në nenin 23 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Statutin e Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010, Planin Rregullues Urban dhe në bashkëpunimin me drejtorët e drejtorive: për Zhvillim Ekonomik, për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi dhe Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis, ka zhvilluar disa takime me investitorin pas parashtrimit të kërkesës.

Sipas aneks-projektit ideor investitori planifikon që në pronën e paluajtshme të komunës të cilën e ka marr në shfrytëzim të hap pikën e shitjes me qëllim që t'i mundësohet shitja e produkteve që do të prodhohen nga veprimtaria shtesë biznesore por edhe gjenerimin e 25 vendeve të reja të punës.

Me qëllim të realizimit të interesit publik, rritjes së vlerës së pronës së komunës, krijimit të hyrave vetanake të komunës, krijimit të vendeve të reja të punës përmes bërjes së politikave të punësimit, propozohet plotësimi dhe ndryshimi për dhënien në shfrytëzim pronën e Komunës investitorit të lartcekur andaj kërkoj nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.


Me kopje të këtij vendimi të njoftohen: Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit të Komunës së Istogut.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

z. Enver Rugova




Komuna e Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

KUVENDI I KOMUNËS /SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY

00 Br.209/2023

Datum: 28.12.2023

Skupština opštine, na osnovu člana 12. stav 12.2 tačka (d), člana 14. Zakona br. 03/L-040, za lokalnu samoupravu, član 11. Zakona o korišćenju i razmeni nepokretne imovine opštine br. 06/L-092, (Službeni list Republike Kosovo br. 10/2019), član 23 Uredbe (VRK) br. 09/2020, o utvrđivanju procedure za davanje na korišćenju i zamenu nepokretne imovine opštine, član 83 Statuta opštine Istok 01 br. 62/2010, član 53 stav 3 Zakona br. 05/L-031, za Opšti upravni postupak za dopunu i izmenu odluke Skupštine opštine 01 br. 13/2020, od 18.02.2020 godine, vezano za dugoročno korišćenje pregovaranjem nepokretne imovine opštine, katastarska jedinica 136-9, katastarska zona - Đurakovac, investitoru Xhevdetu Balaju, vlasniku "Ulpiana Balaj" doo, da na sednici održanoj 28.12.2023 odobri:

ODLUKU

**ZA DOPUNU I IZMENU ODLUKE 01 BR. 13/2020 OD DANA 18.02.2020 ZA
DAVANJU NA KORIŠĆENJE PREGOVOROM NEKRETNINE OPŠTINE,
"ULPIANA BALAJ" DOO**

1. **ODOBRENO** Odluka o dopuni i izmeni Odluke 01 br. 13/2020, odobren u 18.02.2020 od strane Skupštine opštine, za davanje na korišćenje pregovorom na 30 godina, nepokretne imovine opštine, katastarska jedinica Đurakovac od 1935m², investitor Xhevdet Balaj, vlasnik "ULPIANA BALAJ" DOO, sa godišnjom kirijom od 840€ (osamsto četrdeset evra).
2. Prema odluci navedenoj u tački I, izmenu-dopunu znači:
 - 2.1. Dopuni se odluka 01 br. 13/2020 od 18.02.2020 godine prema kojoj se vrši proširenje pružanja usluga i prodaje raznih maloprodajnih proizvoda u katastarskoj jedinici 136-9, katastarska zona - Đurakovac, u cilju obezbeđenja proširenja novih radnih mesta i prodaje proizvoda iz dodatne delatnosti kroz otvaranje prodajnog mesta.
3. Svrha davanja na dugoročno korišćenje nepokretnosti opštine pregovaranjem je razvoj sadašnje delatnosti ove delatnosti, povećanje vrednosti imovine opštine, povećanje investicija kao i kao stvaranje novih radnih mesta prema standardima utvrđenim zakonskim odredbama.

4. Za sprovođenje ove odluke se brinu: gradonačelnik opštine, Direkcija za katastar, imovinu i geodeziju, Direkcija za urbanizam i prostorno planiranje, Direkcija za ekonomski razvoj, Direkcija za inspekciju i Direkcija za Budžet i Finansije.
5. Ova Odluka stupi na snagu 15 (petnaest) dana od dana registracije u kancelariji za protokol Ministarstva nadležnog za poslove lokalne samouprave, kao i 7 (sedam) dana od dana objavljivanja na zvaničnoj internet stranici Opštine.

Obrazloženje

Pravni osnov za usvajanje Predloga ove odluke utvrđen je odredbama Zakona o lokalnoj samoupravi br. 03/L-040, Zakona o korišćenju i razmeni opštinske nepokretne imovine br. 06/L- 092, Uredba (QRK) br. 09/2020, o utvrđivanju procedure za stavljanje u upotrebu i zamenu nepokretne imovine opštine i Statuta opštine Istok 01 br. 62/2010.

Odlukom Skupštine opštine 01 br. 13/2020, od 18.02.2020, investitoru Xhevdetu Balaju, vlasniku „Ulpiana Balaj“ doo. data je na dugoročno korišćenje pregovorom na 30 godina nepokretna imovina opštine, katastarska jedinica 136-9, katastarska zona - Đurakovac, gde je prema idejnom projektu investitora cilj bio: sakupljanje semena: jabuke, kruške, , šljive i dr., zbirka vlastelinskih stabala: malina, borovnica, oren, kupina, žitarice i povrće. Prerada sokova, džemova, marmelada, žitarica, konzerviranje kukuruza i prerada planinskog voća.

Investitor nije bio u mogućnosti da realizuje investiciju u potpunosti, prema idejnom planu predviđanom u slučaju uzimanja imovine opštine na korišćenje putem pregovora, zbog pojave pandemije Covid-19, što je uticalo na održivost realizacije projekta, pa je na osnovu ovog dana 07.12.2023 godine, investitor preko ovlašćenog predstavnika podneo zahtev br. 01-016-49695, u kojem je tražio da se omogući proširenje pružanja usluga prodajom raznih maloprodajnih proizvoda u istoj nekretnini, koje je pregovaračkim putem uzeo u korišćenje, kako bi se osiguralo proširenje novih radnih mesta i sigurna prodaja proizvodi koji će se proizvoditi dodatnom delatnošću, omogućavajući prodaju proizvodnih proizvoda kroz otvaranje prodajnog mesta.

Gradonačelnik opštine, na osnovu člana 11. Zakona o korišćenju i razmeni opštinske nepokretne imovine br. 06/L-092, na osnovu člana 23 Uredbe (VRK) br. 09/2020, o utvrđivanju procedure za stavljanje u upotrebu i zamenu nepokretne imovine opštine, Statuta opštine Istok 01 br. direktije: za ekonomski razvoj, za katastarsku imovinu i geodeziju i Direkcija za urbanizam i životnu sredinu, održale su nekoliko sastanaka sa investitorom nakon podnošenja zahteva.

Prema idejnom aneksu, investitor planira da otvori prodajno mesto u nepokretnostima opštine, koje je uzeo na korišćenje, kako bi mogao prodavati proizvode koji će se proizvoditi iz dodatne delatnosti, ali i stvaranje 25 novih radnih mesta.

U cilju ostvarivanja javnog interesa, povećanja vrednosti imovine opštine, stvaranja sopstvenih prihoda opštine, otvaranja novih radnih mesta kroz politike zapošljavanja, predlaže se da se završi i promeni davanje imovine opštine gore pomenutom investitoru, stoga sam zatražiti od Skupštine opštine davanje saglasnosti na ovaj prijedlog-odluke.

Kopijom ove odluke da se obaveste: Ministarstvo Administracije lokalne samouprave, gradonačelnik opštine, Direkcija za urbanizam i prostorno planiranje, i jedna kopija ostaje u arhivi Skupštine opštine Istok.

Predsedavajući Skupštine,
g. Enver Rugova



Mbështjellësi I lëndës (akteve)

24.12.2019			
01	016	56713	

Akti- lënda vendoset në a.a.

Shenja e klasifikimit _____

Lënda Xhevdet Balaj - Zabllagë

Lëndët e zgjidhura njëkohësisht nr. _____

Numri i ruajtur dhe Afati i ruajtjes _____

Numri nga libri intern i dorëzimit _____

Afati

Zgjidhja e lëndës

Aprovim/ Refuzim

Data _____

Vendi

Përpunoi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS-KOMUNA E ISTOGUT
REPUBLIKA KOSOVO-OPSTINA ISTOK



Komuna e Istogut
Opština Istok

Pranuar Primljeno	24.12.2019		
Drejtorija Direkcija	Nr. Br:	Shtojcë Prilog	Vlerë Vrednost
01	016	56715	

1. Kërkesë për Drejtoratin - Njësinë / Zahtev za Direkciju - Jedinice

KRYETARI I KOMUNES

2. Informatat personale të parashtruesit të kërkesës/Lični podaci podnosioca zahteva:

Emri dhe Mbiemri / Ime i Prezime

Nr. Personal / Lični broj

XHEVDET BALAJ

Adresa e vendbanimit / Adresa i prebivalište

JABLLA QË

(Nr. i shtëpisë/banesës, rruga, fshat teti, kodi postal)/(Br. kuçe/stana, ulica, selo/grad, poštanski kod)

Nr.Tel Fiks/Br.Fiks Tel:

Nr.Tel Mob/Br.MobTel.

mail

3. Shpjegoni më poshtë kërkesën tuaj në detaje / Objasnite dole vaš zahtev u detalje:

KËRKESA ËSHTË E BASHKANGJITUR.

4. Dokumentet shtesë (nëse ka), shëno më poshtë / Navedite priložene isprave (ukoliko imate)

DOKUMENTET JANË TE BASHKANGJITUR

5.

Data / Dana

24.12.2019

Nënshkrimi / Potpis

XHEVDET BALAJ

I nderuar z.Haki Rugova, Kryetar i Komunës se Istogut

E Lus titullin e lartëpërmendurin që sipas mundesive ligjore te na munësoi dhënien me qira të parcellës me nr.136-2 zona kadastrale Gurrakoc në të cilën parcel kemi menduar që të investojm me vlerë mbi 2 milion euro.

Si rezultat i këtij investimi do të përfitojn mbi 50 puntorë si dhe përfitues do të jenë edhe fermeret dhe bujqesit me prodhime vendore të cilat do të paketojnë dhe lansojnë në treg , pjes e këtij objekti do të jet edhe qendra tregtare që do të përfshin edhe një restaurantin-mini bar.

Ju faleminderit për mirkuptim, dhe lusim që kemi përgjigje pozitive nga ana juaj dhe qdo dokument shtes jemt të gatshem ti bashkangjitur. Puna dhe kontributi për shumë vite në diaspor tani kam shprehur vullnetin dhe dëshiren që të kontriboj sa do pak me investimin tim në zbutjen e pa punësis zhvillimin ekonomik në vendlindjen time.

Të bashkangjitur i keni dokumentat : Planin Ideor, planin e Biznesit-qertifikaten, Planin Financiar, Çertifikaten e Pronës, Kopja e Planit.

Me respekt: Xhevdet Balaj Tel:+38344186169

Data: 24.12.2019

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.13/2020	Data: 28.02.2020	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe neni 40 paragrafi 40.2 pika I) të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008). dhe në pajtim me nenin 33. paragrafi 33.1. pika 11) të Statutit të Komunës 01 Numër 62/10 dhe në bazë të nenit 6 paragrafi 1.2 si dhe nenit 11 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03), në mbledhjen e mbajtur më: 28.02.2020, shqyrtoi Propozim - Vendimin e Kryetarit të Komunës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës me negocim dhe mori:

V E N D I M PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Miratohet Propozim - Vendimi i kryetarit të komunës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës me negocim, Njësia Kadastrale Nr. 136-9, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1935 m², Zona Kadastrale- Gurrakoc, e evidentuar sipas certifikatës pronësore me numër të referencës 150/2020 e datës 14.02.2020 si P.SH. SH, i jepet investitorit, z Xhevdet Balaj nga fshati Zabllaq, Komuna e Istogut dhe çmimi për atë sipërfaqe do të jetë 840 € në vit.
2. Afati kohor për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme është (tridhjetë) 30 vite.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës është zhvillimi i aktiviteteve biznesore si dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës sipas projekt të propozuar nga investitori.
4. Autorizohet kryetari i komunës në përputhje me këtë vendim të lidhë marrëveshje me investitorin me të cilin për se afërmi do të përcaktohen, kushtet dhe kriteret për shfrytëzimin të paluajtshmerisë së cekur në piken I të këtij vendimi për shfrytëzim dhe implementim e këtij projekti sipas të cilit i është dhënë kjo pronë.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtoria për Inspektion.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtoria për Inspektion dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.


 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Udhëzuesi

Nr. 01-039-13 Data 06.03.2020

Br: Datum

ISTOG-ISTOK



KRYESUESI I KUVENDIT,
z. Qaush Balaj



Yodanis et al.

Pass-ht Passport No.

P 6799905

BALAJI



XHEVDET

OSTERREICH

ZABLAČE

M

Becky O. Ashworth

BERN

